

Anketa
LSDM me
shqiptarët i del
para VMRO-së

Fq.4



**SINDIKATA
NË ALARM**
Administrata
gjyqësore gati
për grevë

Fq.5



Dua Lipa
**Nazim
Rashidi**

Fq.10



Koha

www.koha.mk



**Orbani s'ka
të ndalur**

Fq.13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3432 · e enjte, 9 gusht 2018

21°C | 32°C

15 DEN

EDITORIAL

**Mbështetësit
e vegjël të
ideve të
mëdha**



Ideja për korrigjimin e kufijve ose për shkëmbim terriroresh, nëse gjen zbatim, nuk do t'i japë Kosovës asnjë pëllëmbë nga Lugina e Preshevës, siç pretendohet, por do t'i sigurojë veriut autonomi territoriale. Me pozitën e saj aktualisht të pafavorshme, Kosova e politikës reale, jo e retorikës folklorike, nuk do të jetë në gjendje të imponojë as zgjidhje simetrike të Luginës... Fq.11

GLOBI

**Prapavija e
tensionimeve
amerikano-
turke**

Fq.15

RAJON

**Pse janë të
rrezikshme
idetë e
korrigjimit
të kufirit me
Serbinë?**

Fq.14



NË PRITJE TË STRATEGJIVE POLITIKE PËR REFERENDUMIN

FRENAT E FUSHATËS NË DORË TË QEVERISË



"Në pajtim me Ligjin për Referendum, Qeveria e Maqedonisë po shqyrton mundësitë për realizimin e një fushate me interes publik, me qëllim informimin rreth çështjes të cilën e trajton Referendumi. Në këtë moment mund të theksojmë se si Qeveri, do të kemi një fushatë informative dhe intensive për çështjen e Referendumit", thotë Muhamet Hoxha

Fq.3

Prodhimtaria nuk mbrohet me barriera

Shkup, 8 gusht - Masa e fundit e Kosovës për mbrojtjen e produkteve vendore me zbatimin e doganës prej 30 për qind për import të prodhimeve bujqësore nga shtetet e rajonit, e që u hoq javën e kaluar, për ekspertët e bujqësisë - ishte e pakuptimtë dhe e paqëndrueshme, sidomos në kohën e tregtisë së lirë dhe tregut të hapur ku duhet të garohet me çmime dhe cilësi për të përfituar konsumatorë. Bile, vlerë-

sojnë afaristët, masat e ndryshme mbrojtëse që janë vendosur kohë pas kohë midis shteteve të rajonit gjatë viteve të kaluara, nuk shkojnë në favor të krijimit të një tregu rajonal që mundëson zhvillim ekonomik, rrit sigurinë dhe stabilitetin politik në Ballkan. Në ndërkohë, në vitet e kaluara kishim më shumë shembuj të vendosjes së pengesave që kanë zgjatur vetëm për disa javë të këmbimit...

Fq.6



EDITORIAL

LOGJKA SOVJETIKE
E MANIPULIMIT
TË FAKTEVE

Emin AZEMI

Etiketa më shpërdoruese që është dëgjuar këto vitet e fundit, ka qenë fjala terrorist, që me lehtësi të madhe iu është veshur individëve të caktuar shqiptarë. Por, ekspertizat, sado që kanë qenë të sajura dhe dirigjuara, asnjëherë nuk kanë arritur të sjellin argumente bindëse se bëhet fjalë për ndonjë veprimtari terroriste të personave, të cilët në momente kritike mund të kenë qenë në ndonjë "vend të gabuar".

Targetimi i "grupit të Kumanovës" me kualifikimin "terrorist", që lidhet me ngjarjet e 9-10 majit, 2015, është shmangia më elegante e institucioneve të drejtësisë për të trajtuar këtë grup me terma adekuat, që do të ishin larg përkufizimeve aktuale.

Gjyqësori në Maqedoni ka shumë punë të pakryera edhe sa i përket semantikës së kualifikimit të ngjarjeve. Në procesin e skringut do të duhej të përfshihet edhe kjo çështje, sepse pretendimi për të qenë një ditë pjesë e BE nënkupton edhe flakjen e nebulozave terminologjike.

Rasti i këtyre djemve të ardhur nga Kosova në Kumanovë, para tri vjetëve, ka prodhuar një triler tragjik që më tepër ka karakter të papërgjegjësive së kombinuar institucionale e individuale, se sa të ndonjë ngjarjeje me konotacion terrorist. Ata u zunë në befasi, gati në gjumë, dhe asnjë ekspertizë nuk ka provuar të na bindë se qëllimi i tyre ishte të vrisnin ndonjë person. Rrethanat e ndodhjes së tyre në "vend të gabuar" dhe "kohë të gabuar" mund të diskutohen, por akti final i aktiviteteve të tyre nuk ka qenë terrorizmi, siç po pretendojnë prokurorët dhe gjykatësit e këtij rasti.

Në logjikën juridike të një shteti, siç është Maqedonia, që ndodhet ende brenda traditave sovjetike të manipulimit me fakte e prova, rastet si ky gjithmonë marrin ngjyrim misterioz me konotacion të konspiracionit, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të humben gjurmët se kush e konstruktoi këtë ngjarje, dhe cilët ishin ideatorët dhe frymëzuesit e kësaj aventure tragjike. Me vetë faktin se në seancat gjyqësore munguan një pjesë e madhe e të apostrofuarve si dëshmitarë të drejtpërdrejt, që u kërkuan nga të akuzuarit, është e mjaftueshme për të kuptuar se ky proces gjyqësor u ngrit mbi një padrejtësi të madhe.

Ngjarjet e 9 dhe 10 majit 2015 nuk ndodhën vetvetiu, në mënyrë stihike. Ato dikush i ka ideuar dhe organizuar. Plot individë nga Maqedonia dhe nga Kosova u kujdesën që këto ngjarje të kenë efektin dhe kontekstin e tyre dhe jo të gjithë individët u penalizuan për veprimet e tyre. Disa humbën jetën, të tjerët u burgosën me qindra vite burg dhe jo pak u dënuan me burgime të përjetshme. Mirëpo çka ndodhi? Jashtë burgut mbetën ata individë që i organizuan ngjarjet e Kumanovës? Në Kumanovë, më 9 dhe 10 maj ranë disa idealistë shqiptarë, që gabimisht u futën në agjendat e matrapazëve shtetërorë të Shkupit e Prishtinës dhe është për t'u habitur se si kjo e vërtetë vazhdon të mbetet disi e pluhurosur me tisin e misteriozitetit dhe paqartësisë.

"Ngjarjet e Kumanovës" duhet ti kalohen PSP-së dhe të ndahet njëherë e përgjithmonë fajësia e atyre që erdhën pa e ditur se ku po vijnë, e që morën dënime kapitale, dhe e të tjerëve që e dinin saktësisht epilogun dhe efektin e këtyre ngjarjeve, e që aktualisht janë më të lirë se zogjtë e malit. Në të kundërtën, "ngjarjet e Kumanovës" do të vazhdojnë të mbeten një batak në fund të një gropë të thellë, e të misterishme, ku secili e ka luksin të projektojë konspiracionet e veta, me mundësi që edhe në të ardhmen të inskenohen trilere të tilla, me aktorë tragjikë që humbin jetën kot për kauza që dikush i shënjestron si "qëllime finale" për politika kaotike. Amnistia, fundja, është e pashmangshme për gjithë ata që bien pre e manipulimeve shtetërore.

DUHET T'I HIQET LAPSI
NGA DORA HASHIM
THAÇIT

"Faza finale e bisedimeve që i servohet shqiptareve si dialog në mes Kosovës dhe Serbisë, në fakt ka qenë dhe mbetet dialog në mes Beogradit dhe Prishtinës i imponuar nga Serbia e qe pala kosovare e ka pranuar si refleks të mosdijes dhe si inercion.

Jo rastesisht, sot Hashim Thaçi, kërkon ta shperndaje pergjegjesine (lexo FAJIN) me pjesën tjetër të spektrit politik në Kosove, e me qellim qe t'u leje atyre "kembet e harushes" ne dore!

Deri tani Parlamenti i Kosovës atij nuk i ka kërkuar llogaridhënie per asnje nenshkrim te demshem per Kosoven (demarkacioni me Mal te Zi, asociacioni apo Zajednica).

Ai gjithmone nënshkruan "marreveshje" kur ka Kosova pushim institucional.

Nëse atij edhe kesaj here i lejohet e njejta, pra ajo që, paramendoni, edhe ai e quan marreveshje te dhimbshme me Serbine, atehere ai me nuk eshte fajtor, por te gjithë ne behemi bashkefajtores!

Kosova zyrtare duhet sa me parë ti heq lapsin nga dora Hashim Thaçit, sepse ai laps është në dorë të gabuar", shkruan në profilin e tij në Facebook, profesori universitar na Lubjana, Martin Berishaj.

KU DALLON LDK DHE
PDK?


"LDK është parti institucionaliste. Kur është në pushtet është më parimore se PDK-ja.

Nuk është se nuk vjedhin, por vjedhin me masë. Këta të LDK-së e hanë pitën, por e lënë tepsinë, kurse këta të Hashimit dhe të Ramushit kur e hanë pitën edhe tepsinë e marrin me vete.

Mirëpo, LDK kur nuk është në pushtet bën veprime historike. Sikur LDK të ishte në pushtet, pa asnjë zhurmë do të merrte pjesë në ceremoninë e varrimit të Adem Demaçit.

Por, kur është në opozitë si edhe në fushatë elektorale LDK-së i shkon për mrekulli politika me të vdekurit.

Rasti i Demaçit ishte ideal për ta!", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, mjeku dhe shkrimtari Liri Loshi.



MEDIACitate

TEZA E NDARJES SË
KOSOVËS DREJT NJË
PAKTI TRUMP-PUTIN

Edhe pse ambasada ruse ka reaguar fuqishëm pas një shkrimi se propozimi i Hashim Thaçit për korigjim të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë është biseduar nga Trump dhe Putin në Helsinki, portal i Kremlinit jep një version dramatik të variantit që po djeg edhe më shumë politikën në Ballkan në këto ditë të nxehta gushti.

Zheljko Cvijanoviç thekson se nëse do të ketë një standard të ri për Kosovën, do të ketë ndarje edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, si dhe në Maqedoni. Ç'ka duket hapur se pazari që pritet të mbyllet në shtator në bisedimet finale për Kosovën do të jetë i "rëndë".

Presidenti Serb Aleksandër Vuçiç, mbajti një konferencë speciale për shtyp, ku deklaroi se "nga bisedimet e reja për Kosovën nuk do të ketë fitore, por të ardhme për Serbinë".

Vuçiç nuk ka komentuar deklaratat për shkëmbim territore por ka kërkuar konsensus. Sipas tij, "dialogu do të jetë konstruktiv dhe nuk ka rrugë tjetër për të zgjidhur këtë çështje".

Daniel Serwer, profesor në universitetin "Johns Hopkins", tha për televizionin që mbulon të gjithë hapësirën e ish-Jugosllavisë, N1, se spekulimet në lidhje me ndarjen e Kosovës nuk tërheqin shumë vëmendje në Uashington dhe paralajmëroi se një ndryshim i mundshëm në kufijve të Kosovës hap Kutinë e Pandorës dhe në Ballkanin Perëndimor, por edhe në vende të tjera të botës.

Serwer tha se nëse Serbia dhe Kosova duan të jenë shtete demokratike si dhe anëtarët e BE-së, nuk sheh arsye pse komunitetet pakicë nuk do të qëndrojnë aty ku janë - në kufijtë ekzistues.

"Gjithçka tjetër do të ishte një shkelje të kufijve. Duke vepruar kështu atëherë "diga e Kosovës" do të çahet dhe do të merrte shumë territore më vete", tha analisti amerikan.

Zeljko Cvijanoviç megjithatë thekson se vendet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën janë në kriza të rënda dhe ka gjasa që të ndryshojnë qëndrimin.

"Por edhe Kina tani nuk po tregohet shumë ortodokse për Kosovën. Madje Turqia ia ka kërkuar hapur njohjen dhe Pekini e Ankaraja po bëhen gjithnjë e më shumë miq të afërt", thotë Zeljko Cvijanoviç. Megjithatë shpresohet se Donald Trump nuk do ta miratojë ndarjen e Kosovës.

"Trump nuk mund të thoshte publikisht për momentin se administrata e tij e ka lënë pas dore Kosovën. Pse? Sepse gjithçka filloi në Kosovë. Trump mund të thotë: 'le ta mbajmë këtë Kosovë të qetë, sepse ndryshe na çon në probleme të mëtejshme'. Kjo është vrima e vogël që hap shpresë për Serbinë, se ai do të kërkojë një marrëveshje me presidentin rus Vladimir Putin.

Natyrisht, do të ishte graduale, e ngadalshme, do të vazhdonte për disa periudha. Por unë besoj se është e mundur që diçka e tillë të ndodhë", përfundon Cvijanoviç.

(SPUTNIK, 8 gusht)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË KA QENË PARIKU?

Pariku, gjatë periudhës së feudalizmit (shek. IX-XIV), ka qenë kategori kryesore e popullsisë fshatare të varur. Parikët ishin të varur së pari prej shtetit bizantin, të cilit i jepnin detyrime në natyrë, të holla dhe shërbime (renta qendrore). Me zhvillimin e marrëdhënieve feudale, pjesa më e madhe e rentës që nxirrej nga fshatarët, u

shkonte feudalëve të veçantë. Parikët kishin ekonominë e tyre, punonin me mjetet e veta ngastrat që mbanin nga feudali ose entet fetare e për të cilët u jepnin këtyre detyrimet. Për të ndaluar mosdhënien e detyrimeve, shteti mori masa për t'i regjistruar parikët bashkë me tokën dhe për të ndaluar largimin e tyre.

“Në pajtim me Ligjin për Referendum, Qeveria e Maqedonisë po shqyrton mundësitë për realizimin e një fushate me interes publik, me qëllim informimin rreth çështjes të cilën e trajton Referendumi. Në këtë moment mund të theksojmë se si Qeveri, do të kemi një fushatë informative dhe intensive për çështjen e Referendumi”, thotë Muhamet Hoxha

NË PRITJE TË STRATEGJIVE POLITIKE PËR REFERENDUMIN

FRENAT E FUSHATËS NË DORË TË QEVERISË



Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 8 gusht - Fushata për organizimin e Referendumi do të jetë qeveritare ndërkah partitë në pushtet së bashku do ta mbështesin ekipin qeveritar që do të bëjë fushatën, kjo sipas asaj që flitet jo zyrtarisht në Qeveri. Deri tek ky qëndrim ka ardhur, e që pritet të bëhet publike së shpejti, për shkak se duan ti japin karakter shtetëror Referendumi duke mos bërë fushatë speciale partiake. Por edhe nga prononcimi për gazetën KOHA i zëdhënësit të Qeverisë, Muhamet Hoxha, jep të kuptohet qartë se Qeveria do të jetë promotorja kryesore për fushatën pro Referendumi.

“Në pajtim me Ligjin për Referendum, Qeveria po shqyrton mundësitë për realizimin e një fushate me interes publik, me qëllim të informimit rreth çështjes të cilën e trajton Referendumi. Në këtë moment mund të theksojmë se si Qeveri do të kemi një fushatë informative dhe intensive për çështjen e referendumi”, thotë Hoxha. Qytetarët, shton ai, do të informohen për benefitet e Marrëveshjes me Greqinë, për zgjidhjen e kontestit të emrit, për hapjen e perspektivës së vendit për anëtarësim në NATO me çka përfituesit direkt do të jenë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë.

“Fillojmë negociatat për anë-

tarësim me BE dhe bëhemi anëtarë e NATO-s që ka rëndësi strategjike për Maqedoninë. Mbështetja e Referendumi nënkupton mbështetje e integritetit të vendit në NATO dhe BE. Qytetarët duket se e kanë të qartë këtë dhe nuk dyshojmë që vota e tyre do të jetë pro”, thotë Hoxha.

Aleanca për Shqiptarët ndërkah do të pret mbledhjen e Kuvendit Qendror si organi më i lartë vendim-marrës, i cili do të vendosë për të gjitha detajet rreth Referendumi përfshirë dhe fushatën. “Vlerësojmë se fushata deritanishme e Qeverisë LSDM-BDI nëpërmjet afisheve dhe materialeve propagandistike ‘Do të hymë në NATO dhe BE si Maqedonas’, ‘Me marrëveshjen ruhet gjuha maqedonase’, ‘Hapet shpresa maqedonase’... të gjitha nën emrin ‘Maqedonas’ edhe atë të shkruara vetëm në gjuhën maqedonase, tregon se kjo Qeveri shkel mbi vlerat dhe realitetin multietnik në vend, duke e apostrofuar vetëm identitetin maqedonas, kjo tendencë padyshim që i irriton shqiptarët sepse i paraqet si të paqenë në këtë shtet”,

thotë zëdhënësi i ASH-së, Flakron Besheti. Qeveria, shton Besheti, duhet medoemos që të elementin shqiptarë bashkë me atë maqedonas ta ketë në fokusin kryesor të fushatës për Referendumin. “Qeveria LSDM dhe BDI me këtë lloj fushate nuk e paraqet Maqedoninë të barabartë ndaj qytetarëve të saj ashtu siç e paraqiste dikur kryeministri Zaev, por vetëm maqedonase. Shqiptarët duan të anëtarësohen si shqiptar dhe evropian në NATO dhe BE, por jo si maqedonas”, thotë Besheti. Sekretari i përgjithshëm i Lëvizjes BESA, Arianit Hoxha, nga ana tjetër thotë se ende partia e tij është në fazën fillestare në përpilimin e Strategjisë për fushatën për Referendumin. Ai përmend javën e parë të shtatorit kur do të dalin me detaje para opinionit. Megjithatë, sipas Hoxhës, Lëvizja BESA në momentin që do të hapet debati për ndryshime kushtetuese, do të kërkojë heqjen e termit “20 për qind” për shqiptarët dhe gjuhën shqipe.

Në taborin maqedonas nuk flitet shumë për fushatë sa që ka zëra

kundërshtues ndaj Referendumi edhe atë në taborin e majtë, jo vetëm të djathtë. Të mërkurën, e partia politike “E Majta” të Gjykata Kushtetuese ka dorëzuar iniciativë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimit për shpalljen e Referendumi, me të cilin kërkohet prishja e tij. Sipas tyre, ka shumë arsye që të ndërpriten aktivitetet përgatitore të Referendumi që do të mbahet më 30 shtator.

“Meqë në iniciativë kërkohet parametër kohor, kjo do të thotë se iniciativë procedurë të shpejtë dhe presim që Gjykata Kushtetuese, pas pushimeve vjetore, që i bie para Referendumi, të deklarohet për kërkesën”, tha Dimitar Apasiev. Sipas Apasievit, Referendumi kërkohet të prishet për shkak se nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën, Ligjin për Referendum, standardet evropiane dhe praktikën e parashtruar në Komisionin e Venedikut. Sipas të dhënave të partisë “E Majta”, vetëm 14 për qind e qytetarëve e përkrahin marrëveshjen e nënshkruar në Prespë, dhe paralajmëruan se do ta bojkotojnë Referendumin.

88 për qind e shqiptarëve “për”

Referendumin

Shkup, 8 gusht - Mbështetje në pyetjen e Referendumi “A jeni për anëtarësim në BE dhe NATO, me pranimit e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë” do të jepnin 41.5 për qind, ndërsa kundër janë deklaruar 35.1 për qind, tregojnë rezultatet nga hulumtimi i mendimit publik të cilin për Qendrën Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) e zbatoi agjencia M-prospekt në periudhën prej 24 korrikut deri më 1 gusht të vitit 2018. Shumica e të anketuarve 66.4 për qind kanë deklaruar se do të dalin të votojnë në Referendum, përderisa 19.8 për qind tashmë janë të përcaktuar që të përfshihen në iniciativën për bojkot të referendumi.

Gati 12 për qind ende nuk kanë vendosur. Sipas rezultateve, te maqedonasit mbështetje do të jepnin 27.4 për qind, përderisa kundër do të ishin 45.2 për qind. Te shqiptarët, “për” do të deklaroheshin 88 për qind, ndërsa kundër 2.2 për qind. Mbështetje më të vogël japin të rinjtë 49.2 për qind, ndërsa në raport me përcaktimin partiak - simpatizuesit e të dyja partive më të mëdha janë në linjë me qëndrimin partiak, 75 për qind prej tyre të LSDM-së janë “për”, ndërsa 68 për qind nga mbështetësit e VMRO-DPMNE-së janë “kundër”, por devijim më të madh ka te LSDM - 14.6 për qind të simpatizuesve të tyre do të votojnë “kundër”, përkundër 4.7 për qind nga ata të VMRO-DPMNE-së të cilët do të votojnë “për”. Në mënyrë shtesë, 20.6 për qind nga ata të VMRO-së kishin deklaruar se nuk do të dalin në votim. Pa marrë parasysh rezultatit e Referendumi, është e qartë mbështetja për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë në BE (80.4 për qind) dhe NATO (79.9 për qind). Të dhënat e hulumtimit janë grumbulluar përmes telefonit (CATI) në periudhën nga 24 korriku deri më 01 gusht të vitit 2018. Anketa është zbatuar në ekzemplarë të stratifikuar disalojsh nga 1026 të anketuar më të moshuar se 18 vjeç.

KSHZ GATI PËR REFERENDUMIN

Fillon kontrolli në Listën Zgjedhore

Shkup 8 gusht - Prej sot (9 gusht) fillon kontrolli i të dhënave në Listën zgjedhore për zbatimin e referendumi më 30 shtator. Inspektimi do të zgjasë deri më 23 gusht të vitit 2018 deri në orën 24:00.

KSHZ-ja ju bëri thirrje qytetarëve t'i kontrollojnë të dhënat në Listën zgjedhore, dhe nëse mendojnë se nevojitet, të kërkojnë ndryshim, plotësim apo fshirje të të dhënave në to. Kontrollin e të dhënave mund ta kryejnë përmes ueb faqes së KSHZ-së <https://izbirackispisok.gov.mk/> dhe në zyrat rajonale dhe zyrat e KSHZ-së. Kërkesat për ndry-

shim, plotësim apo fshirje të të dhënave në listën zgjedhore, qytetarët i dorëzojnë në zyrat rajonale dhe zyrat e Komisionit shtetëror zgjedhor, ndërsa shtetasit e RM-së të cilët janë në punë të përkohshme apo qëndrim jashtë vendit, kërkesat i dorëzojnë në mënyrë elektronike deri te KSHZ-ja. Nga dita e fillimit të kontrollit deri në fund shtetasit e RM-së të cilët janë për punë të përkohshme apo qëndrim jashtë vendit, mund të dorëzojnë fletëparaqitje, të nënshkruar me dorë deri tek Përfaqësia Diplomatike-Konsullore (PDK) apo në mënyrë elektronike

nëpërmjet ueb aplikacionit të KSHZ-së.

Fletëparaqitjet PDK-të, gjegjësisht zyrat konsullore në afat prej dy ditësh pas mbarimit të kontrollit duhet t'i dorëzojnë në formë elektronike deri te MPJ, ndërsa MPJ, më së voni deri më 27 gusht duhet ta informojë KSHZ-në. Ndryshe, diaspora për çështjen e referendumi do të prononcohet më 29 shtator.

KSHZ-ja për kërkesat dhe fletëparaqitjet e qytetarëve është e obliguar të vendos me vendim në afat prej 48 orëve nga dita e pranimit të kërkesave. Nëse sille vendim me të

cilin refuzohet kërkesa, qytetari në afat prej 24 orëve nga pranimit i vendimit mund të ngritë padi në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme në afat prej 24 orëve pas pranimit të padisë dhe vendimit menjëherë ia dorëzon vendimin paditësit në formë elektronike. Lista zgjedhore e cila mund të shqyrtohet publikisht është me të dhënat e qytetarëve të cilët më së voni deri më 30 shtator të vitit 2018 kanë hyrë në moshën madhore. Lista e adresave të zyrave rajonale dhe zyrave të KSHZ-së mund të gjendet në faqen zyrtare të këtij institucioni. (E.H)

ANKETË E QMBN-së LSDM me shqiptarët i del para VMRO-së

Shkup, 8 gusht - VMRO-DPM-NE vazhdon të kryesojë tek elektorati maqedonas me 31.2 për qind mbështetje, derisa LSDM ka 28.3 për qind. Kështu tregojnë rezultatet nga hulumtimi të cilin për Qendrën Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) e zbatoi agjencia M-prospekt në periudhën prej 24 korrikut deri më 1 gusht të vitit 2018.

Megjithatë, rritjen e mbështetjes së LSDM-së karshi VMRO-së e bën votuesi shqiptarë, konkretisht 8 për qind e të anketuarve shqiptarë kanë theksuar se mbështetin LSDM-së kundrejt më pak se 1 përqindëshit që janë shprehur për VMRO-në. Në përgjithësi, tregon anketa, LSDM ka 24.4 për qind mbështetje, VMRO 24, derisa tek partitë shqiptare - BDI e Ali Ahmeti ka gati dyfishin e mbështetjes karshi Aleancës për Shqiptarët dhe Lëvizjes BESA. Në pyetjen "Nëse do të ketë zgjedhje parlamentare", 6.9 për qind janë shprehur se do votojnë për BDI-në, 2.7 për qind ASH dhe 1.7 për qind për Lëvizjen BESA. "Nuk e dinë" apo "nuk do të votojnë" janë shprehur 37.8 për qind e të anketuarve. Ndryshe, të dhënat e hulumtimit janë grumbulluar përmes telefonit (CATI) në periudhën nga 24 korriku deri më 1 gusht të vitit 2018. Anketa është zbatuar në ekzemplarë të stratifikuar disallojesh nga 1026 të anketuar më të moshuar se 18 vjeç. (R.K)

Vetëm Qeveria i arrin 76 për qind të indikatorëve për transparencë, ministritë deri në një mesatare prej 46 për qind, ndërsa institucionet e tjera shtetërore arrijnë të kapin një shkallë transparence prej 24 për qind. Mungesa e transparencës shkaktohet me mungesën e sanksioneve për ato institucione që insistojnë të jenë më pak të hapur për opinionin

Koha

Evis HALILI

Shkup, 8 gusht - Publikimi i informacioneve në faqet elektronike, deklasifikimi i dokumenteve, publikimi i marrëveshjeve të nënshkruara me investitorë, i shpenzimeve të funksionarëve dhe institucioneve..., janë disa prej treguesve pozitivë që e rendisin Maqedoninë si një prej vendeve me ekzekutiv më transparent në rajon. Rezultatet janë marrë pas realizimit të pak kohëve më parë të një hulumtimi me disa vende të rajonit nga fondacioni Metamorfozis me qëllim për të vlerësuar se ku qëndrojnë vendet fqinjë sa i takon llogaridhënies dhe transparencës së demokracive ballkanike.

Në këtë hulumtim vihet në dukje se ekzekutivi e ka përmirësuar transparencën e saj në formë drastike duke u renditur e dyta në këtë listë, ndërsa në vend të parë është vetë Qeveria, e cila është meritore për rangimin në përgjithësi të Maqedonisë, falë aritjes së përqindjes prej 49 për

MUNGOJNË SANKSIONET, MUNGON LLOGARIDHËNIA

QEVERIA MË TRANSPARENTE SE MINISTRITË



qind të indikatorëve. Fillimisht është vlerësuar angazhimi i qeverisë për të publikuar në sajtin e saj të gjitha seancat, procesverbalet dhe njoftimet e rregullta nga seancat e zhvilluara, deklasifikimi i një sërë dokumentesh dhe publikimi i marrëveshjeve të arritura. Sipas kërkesave të vetë Qeverisë edhe ministritë filluan të funksionojnë në këtë formë, bazuar tek Strategjia për reforma në administratë. Vetëm Qeveria i arrin 76 për qind të indikatorëve për transparencë, ministritë deri në një mesatare prej 46 për qind, ndërsa institucionet e tjera shtetërore arrijnë të kapin një shkallë transparence prej 24 për qind. Mungesa e transparencës shkaktohet me mungesën e sanksioneve për ato institucione që insistojnë të jenë më pak të hapur për opinionin.

"Praktika ka treguar se nuk ka institucion që është 'ndëshkuar'

pasi që nuk ka qenë mjaftueshëm transparent. Janë krijuar dallime të mëdha në transparencën e Qeverisë, ministritë dhe organet e tjera. Në Maqedoni hulumtimi ka treguar se indeksi i transparencës bie dukshëm pas Qeverisë e deri tek institucionet e tjera shtetërore. Prandaj edhe koncepti i transparencës duhet të zgjidhet në mënyrë sistematike", rekomandohet në hulumtim. Niveli i transparencës së ministrive në Maqedoni është i ngjashëm me ato të tjerat në rajon. Mesatarja e përbushjes së kriterëve në Maqedoni është 46 për qind, ndërsa e rajonit 42 për qind. Megjithatë të ndara veçmas ministritë kanë shkallë të ndryshme transparente. Më e hapura me informacione është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale 964 për qind, Ministria e Financave (63 për qind), ndërsa më keq është Ministria e Drejtësi-

së (32 për qind). Mangësia më e madhe e ministrive sa i takon aritjes së indikatorëve është publikimi i të dhënave për parandalimin e konfliktit të interesave. Në faqet e tyre nuk publikohen listat e funksionarëve, madje as nuk vendosin link me Komisionin për parandalimin e korrupsionit. Sa i takon organeve të tjera të pushtetit ekzekutiv vlerësimi për transparencën e tyre është jashtëzakonisht i ulët, me indikatorë që përmbushen vetëm 24 për qind. Në përgjithësi, Qeveria e Maqedonisë e përmbush indeksin e transparencës me 69 për qind, indeksin e aksesit me 77 për qind, indeksin e efektivitetit me 99 për qind dhe indeksin e integritetit me 78 për qind. Sa i takon kësaj të fundit, vendi me plotësimin më të lartë të indeksit të integritetit në rajon është Mali i Zi me 89 për qind.

PENTAGONI PËRSHËNDET PUNËN E MPB-së

"CELULA 3", RIATDHESIM I SHTETASVE TË MAQEDONISË

Shkup, 8 gusht - Pas një presioni disa muor nga SHBA-të, institucionet e sigurisë dhe drejtësisë të Maqedonisë kanë pranuar riatdhësimin e disa shtetasve maqedonas që kanë marrë pjesën në frontet e luftës në Irak dhe Siri. Sipas agjencisë së lajme "Associated Press", shtatë personat e dyshuar për pjesëmarrje në formacionet e ISIS-it, në Irak dhe Siri, të martën janë transferuar në Maqedoni. Siç raportojnë mediat e huaja, përveç Maqedonisë, pranimin e riatdhësimit të shtetësive të tyre kanë bërë

edhe disa shtete tjera. Në artikullin e "Associated Press" thuhet se shteti i Maqedonisë është prej shteteve të rralla që ka pranuar riatdhësimin e terroristëve të arrestuar nga Forcat Demokratike Siriane, grup ky që vepron në kuadër të mbështetjes që i jep SHBA. "Bëhet fjalë për gjithsej 600 luftëtarë që pritet të transferohen në më shumë shtete të botës, megjithatë problemi i SHBA-ve është se shumë shtete të BE-së refuzojnë ti pranojnë përsëri në vendet e tyre", shkruajnë mediat e

huaja. Ndryshe, edhe pse MPB-ja nuk ka pranuar të tregoj mënyrë e arrestimit, të dhënat e "Dojçe Velle" flasin se shtatë shtetasit e Maqedonisë, të dyshuar për pjesëmarrje në luftërat e huaja, organeve të policisë u janë dorëzuar drejtpërdrejtë përmes linjës së fluturimit, e cila ka ateruar në aeroportin e Shkupit.

Njëherësh, Pentagoni ka përshëndetur vendimin e Maqedonisë ta pranojë grupin e shtetasve të saj, të cilët si ushtarë të huaj, janë robëruar në Siri. MPB ditë më parë

njoftoi se në një aksion të përbashkët me Komandën e Koalicionit Antiterrorist Global dhe Forcat Demokratike Siriane, kanë arrestuar shtatë shtetas të Maqedonisë, të cilët kanë luftuar në fushëbetejat në Siri dhe Irak.

Zëdhënësi i Pentagonit, Shon Robertson, për CNN deklaroi se Forcat Demokratike Siriane deri në korrik kanë robëruar një numër të konsiderueshëm luftëtarësh prej më shumë se 40-të vendeve. Mes tyre, sipas Robertson, ka pasur rreth 40 mercenarë nga Rusia, 10

nga Gjermania dhe një numër më i vogël nga Franca. Nuk është saktësuar nëse mes tyre, përveç shtatë shtetasve të Maqedonisë, ka edhe shtetas të tjerë të vendit tonë. Zëdhënësi Erik Pahon, megjithatë, për "Washington Times" deklaroi se Maqedonia ka treguar shembull për të gjithë anëtarët e Koalicionit Global, si të mposhtet ISIS-i dhe theksoi se luftëtarët e huaj nuk janë problem vetëm për Sirinë apo për rajonin, por siç sqaroi, ata janë problem global që kërkon bashkëpunim global.

Kryetari i Sindikatës së Administratës Gjyqësore, Peco Grujoski, njofton se nëpunësit e gjykatave të vendit janë të vendosur për grevë nëse deri në fund të muajit nuk plotësohen kërkesat e tyre

PARALAJMËROHET SHTATOR I "NXEHTË"

ADMINISTRATA GJYQËSORE GATI PËR GREVË



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 8 gusht - Durimit të administratës gjyqësore po i ofrohet fundi. Nëse deri në fund të muajit nuk ju kthehen 330 mijë euro, mjete këto të marra nga Këshilli Gjyqësor pas protestave të vitit 2016, Sindikata dhe Shoqata e Administratës Gjyqësore do të fillojnë grevë të përgjithshme në nivel republikan. Përveç kësaj, greva e paralajmëruar pritet të mbahet edhe për shkak të mos ndryshimeve ligjore të Ligjit për shërbimin gjyqësor, respektivisht rritjen e shtesave mujore deri në 35 për qind për administratën gjyqësore.

Kryetari i Sindikatës së Administratës Gjyqësore, Peco Grujoski, për gazetën KOHA njofton se nëpunësit që punojnë nëpër të gjitha gjykatat e vendit kategorikisht janë të prerë se, nëse deri në fund të muajit nuk plotësohen kërkesat e tyre, ata do të fillojnë me protesta dhe grevë. Kësisoj, ai thekson se SACJ-i, me automatizëm do ti mbështesë anëtarët e tyre në rrugëtimin drejtë përmbushjes së kërkesave të kamotshme.

"Faktin se paratë e grevistëve nga administrata gjyqësore, të cilët gjatë vitit 2016 për një muaj e gjysme e bllokuan punën e gjykatave, janë 'konfiskuar' në mënyrë të padrejtë e ka konfirmuar Inspektorati i punës dhe zyra e Avokatit të Popullit. Jemi të vetëdijshëm për dispozitën e cila qëndron në Ligjin për shërbimin gjyqësor, ku thuhet se në rast të grevës, nëpunësit gjyqësor paga mujore i paguhet në vlerë prej 60 për qind, përderisa kontributet paguhet në minimum. Këtë dispozitë aspak nuk e kontestojmë. Mirëpo, problemi lind se kryetari i Këshillit Gjyqësor, Zharko Karaxhovski, gjatë kohës kur janë përgatitur vendimet për rroga, u shkruan kryetarëve të gjykatave që për çdo grevistë, veç e veç të përgatiten vendime indivi-

PECO GRUJOVSKI

Ne e dimë se 40 për qind e rrogës, gjatë kohës kur protestojmë - na ndalohet, mirëpo ky vendim duhet të mbështetet në bazë të procedurave ligjore. Ministria e Drejtësisë dhe Qeveria duhet ta kenë parasysh se edhe ndryshimet e Ligjit për nëpunësit e prokurorëve, ku shtesat u rritën deri në 35 për qind, nuk respektohet siç duhet. Për çdo muaj, para gjykatave zhvillohen konteste gjyqësore për pranimin e këtyre mjeteve dhe të njëjtat fitohen

duale. Por, ai brenda një kohë të shkurtër e ndryshon këtë vendim dhe i obligon arkëtarët e gjykatave që të gjithë grevistëve t'u minusohe nga 40 për qind e pagave. Me këtë veprim, ai e ka keqpërdorur pozitën zyrtare, për të cilën kemi ngritur kallëzim penal, i cili deri sot nuk e di sa e është proceduar nga Prokuroria. Njëkohësisht, arsye shtesë për grevën e paralajmëruar është edhe mos ndryshimi i Ligjit për shërbimin gjyqësor, ku kërkohet rritjen e shtesave deri në 35 për qind", tha Grujoski.

Paralajmërimet për grevë dhe protesta të aktualizuara nga Sindikata dhe Shoqata e Administratës Gjyqësore, vijnë pas një sërë takimesh me drejtuesit e Qeverisë, të cilët deri më sot nuk kanë gjetur asnjë zgjidhje. Lidhur me këtë çështje, Peco Grujoski nënvizon se në takimin me kryeministrin Zoran Zaev, është konstatuar se Ministria e Financave dhe ajo e Drejtësisë duhet të gjejnë një zgjidhje ligjore për kthimin e 330 mijë eurove, para këto që ju i takojnë administratës gjyqësore.

"Qeveria ka kërkuar të dhëna nga çdo gjykatë për të vërtetuar se çdo nëpunësi gjyqësor sa mjete i janë marrë. Ndërkohë, kryeministrin kanë tentuar ta bindin se ne si Sindikatë, nuk jemi në të drejtë, duke u arsyetuar se paratë janë marrë në mënyrë ligjore. Ne e dimë se 40 për qind e rrogës, gjatë kohës kur protestojmë - na ndalohet, mirëpo ky vendim duhet të mbështetet në bazë të procedurave ligjore. Ministria e Drejtësisë dhe Qeveria duhet ta kenë parasysh se edhe ndryshimet e Ligjit për nëpunësit e prokurorëve, ku shtesat u rritën deri në 35 për qind, nuk respektohet siç duhet. Për çdo muaj, para gjykatave zhvillohen konteste gjyqësore për pranimin e këtyre mjeteve dhe të njëjtat fitohen. Ndërkohë, implikimet për

arkën buxhetore janë të mëdha", thekson Grujoski.

Zëdhënësi i Ministrisë së Drejtësisë, Vladimir Vellkov, lidhur me këtë çështje thotë se dikasteri qeveritar i drejtuar nga ministrja Renata Deskovska, është i hapur për diskutim dhe se brenda këtij muaji, pritet të zhvillohet një takim me drejtuesit e Sindikatës së Administratës Gjyqësore. "Për momentin janë duke u shqyrtuar kërkesat e nëpunësve të administratës gjyqësore dhe besojmë se për një afat të shkurtër, para muajit shtator, të realizohet një mbledhje me palët e theksuara", thonë nga Ministria e Drejtësisë.

Ndryshe, gjatë grevës në gjyqësor që u zhvillua në periudhën qershor-korrik në 2016, para Ministrisë së Drejtësisë dhe para objekteve të gjykatave jashtë Shkupit, protestuan një numër i konsiderueshëm i nëpunësve gjyqësor. Përrjashtim bëjnë vetëm administrata e Gjykatës Penale të Shkupit, e cila asokohe llogaritej e shantazhuar. Rritja e shtesave për nëpunësit gjyqësor, sipas drejtuesve të sindikatave, nuk paraqet obligim të patjetërsueshëm që paga të paguhet plus 35 për qind, por varësisht angazhimit dhe detyrës që e kryen një nëpunës gjyqësor, rroga mujore ti paguhet plus 10, 20 apo 35 për qind më tepër.



Paditet Jakimovski

Shkup, 8 gusht - Ish-kryetari i Komunës së Karposhit, Stevčo Jakimovski, mbrëmë është arrestuar dhe gjendet në njërin prej stacioneve policore në Shkup. Deri në fund të ditës pritet ai të nxirret para gjykatës në procedurë paraprake. "Stevčo Jakimovski mbrëmë rreth orës 23 e 30 minuta është privuar nga liria. Në pajtim me Ligjin për procedurë penale vijojnë afatet dhe në 24 orët e ardhshme ai duhet të nxirret para gjykatës në procedurë paraprake. Deri atëherë ai do të jetë në stacion policor. Presim sot të dalim para gjykatës në procedurë paraprake kur do të dihet nëse do të ketë propozim- masa nga prokuroria dhe organet tjera kompetente", deklaroi avokati i ish-kryetarit të Komunës, Viktor Cvetkovski. Sipas Cvetkovskit, ky është sulm ndaj angazhimit politik të Stevčo Jakimovskit. Policia financiare dje hyri në disa objekte banesore të familjes Jakimovski duke kërkuar dokumente për raste të caktuara. Tani për tani nga policia financiare nuk ka informacione zyrtare.

Shkup, 9 të lënduar në 18 aksidente

Shkup, 8 gusht - Nëntë persona janë lënduar më lehtë në 18 aksidente të regjistruara në rrethinën e SPB Shkup, gjatë ditës dhe natës së kaluar. Në aksidentet, në dhjetë raste është shkaktuar dëm material. Policia e komunikacionit ka sanksionuar 51 shoferë për tejkalimin e rregullit të shpejtësisë, janë përjashtuar nga komunikacioni 16 shoferë, 11 prej tyre para së të pajisen me të drejtën për të drejtuar automjetin, tre kanë qenë nën ndikimin e alkoolit, ndërsa dy kanë qenë shoferë fillestar. Nga komunikacioni janë përjashtuar edhe 12 automjete të parregjistruara. Ndryshe, janë shqiptuar 129 masa për parkim jo të rregullt, ndërsa "karrotreci" ka ngritur 54 automjete.

Paditet polici që i vodhi celularin një emigranti

Shkup, 8 gusht - Një polic nga Qendra Rajonale për Punë Kufitare Veri ka marrë kallëzim penal për marrjen celularit një emigranti dhe për dhënie të vërtetimit fiktiv për gjësendet e kthyera. Siç kumtoi MPB, Sektori për Kontroll të Brendshëm, Hetime Kriminallistike dhe Standarde Profesionale në MPB, deri te Prokuroria

Themelore Publike Kumanovë, ka ngritur kallëzim penal kundër Z.S. - i punësuar në QRPKV për shkak të ekzistimit të dyshimit për vepër të kryer penale "keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar", të dënueshëm sipas nenit 353 nga Kodi penal i Republikës së Maqedonisë. I denoncuari, në cilësi të nëpunësit

policor përgjegjës, ka vepruar në kundërshtim me procedurat për gjësendet e marra për kohësisht-celular nga një emigrant i arrestuar. Ka dhënë urdhër të përgatitet vërtetim fiktiv për gjësendet e kthyera. Kundër tij është ngritur edhe procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore.



KUR NJË IMPORTUES ZËVENDËSON TJETRIN

PRODHIMTARIA NUK MBROHET ME BARRIERA

Masat për mbrojtjen e produkteve vendore, për ekspertët e bujqësisë, janë të pakuptimta dhe të paqëndrueshme, sidomos në kohën e tregtisë së lirë dhe tregut të hapur ku duhet të garohet me çmime dhe cilësi për të përfituar konsumatorë

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 8 gusht - Masa e fundit e Kosovës për mbrojtjen e produkteve vendore me zbatimin e doganës prej 30 për qind për import të prodhimeve bujqësore nga shtetet e rajonit, e që u hoq javën e kaluar, për ekspertët e bujqësisë - ishte e pakuptimtë dhe e paqëndrueshme, sidomos në kohën e tregtisë së lirë dhe tregut të hapur ku duhet të garohet me çmime dhe cilësi për të përfituar konsumatorë. Bile, vlerësojnë afaristët, masat e ndryshme mbrojtëse që janë vendosur kohë pas kohë midis shteteve të rajonit gjatë viteve të kaluara, nuk shkojnë në favor të krijimit të një tregu rajonal që mundëson zhvillim ekonomik, rrit sigurinë dhe stabilitetin politik në Ballkan. Në ndërkohë, në vitet e kaluara kishim më shumë shembuj të vendosjes së pengesave që kanë zgjatur vetëm për disa javë të këmbimit të lirë të mallrave në rajon.

Vitin e kaluar, Doganat e Shqipërisë vendosën një rregull të ri, ku për patatet dhe qepët e Kosovës, u rrit referenca tregtare nga 0.14 në 0.18 euro, që nënkuptonte një pamundësi konkurruese në tregun e



DOMATET DHE SHALQIRI KRYESON EKSPORTIN E MAQEDONISË

Maqedonia është në pozitën e 27-të në botë sipas eksportit të domateve, ndërsa në të 33-ën sipas eksportit të shalqirit, publikoi faqja ndërkombëtare e specializuar për statistikë www.worldstopexports.com. Vitin e kaluar vendi ka eksportuar domate në vlerë prej 17.1 milionë dollarë që është 0.2 prej eksportit botëror, ndërsa eksporti i shalqirit ka arritur 2.9 milionë apo, gjithashtu, 0.2 për qind prej eksportit botëror. Për importin e domateve Maqedonia është radhitur në pozitën e 63-të me sasi të importuara në vlerë prej 2.9 milionë dollarësh që është për 0.03 për qind

Shqipërisë. Një masë e tillë u anulua pas dy javësh nga ana e autoriteteve shqiptare. Probleme të ngjashme në eksport dhe import kishte para katër vitesh edhe midis Maqedonisë dhe Serbisë. Mirëpo, pas takimeve të dikasterëve të bujqësisë nga të dyja shtetet, u mundësua që gruri dhe mielli nga Serbia të eksportohen lirshëm në Maqedoni, ndërsa vera dhe domatet nga Maqedonia të mund të hyjnë lirisht në Serbi.

Masa të ngjashme për mbrojtjen e prodhimit vendore të grurit që i vendosi Maqedonia kundrejt Kosovës para katër vi-

tesh, gjithashtu nuk kishte sens në përgatitjen e shteteve të rajonit që nesër të anëtarësohen në BE, shtojnë më tej njohësit e bujqësisë.

"Masa të tilla të mbrojtjes së prodhimit bujqësore që vendosen nga cilido shtet në rajon, edhe pse në shikim të parë sjellin dobi për prodhuesit vendor, megjithatë në aspekt afatgjatë sjellin vetëm dëme, pasi në kushtet e një konkurrence të madhe të tregtisë në rajon dhe botë, vendin e prodhimeve që ju vendosen barrierat do ta zënë prodhimet nga shtetet tjera. Në këtë mënyrë, vetëm zëvendësohet një importues me

prej importit në korniza botërore. Sipas "Worldstopexports", liderë botërorë në eksportin e domateve janë Holanda, Meksika, Spanja, Maroku dhe Kanadaja me 416 milionë deri në dy miliardë dollarë të realizuara, ndërsa në eksportin e shalqirit me 81.6 milionë dollarë deri në 364.6 milionë të realizuara janë Spanja, Meksika, SHBA-ja, Holanda dhe Italia. Importuesit më të mëdhenj, nga ana tjetër, të domateve janë SHBA-ja, Gjermania, Franca, Britania e Madhe dhe Rusia me import të realizuar prej 558.7 milionë dollarësh deri në 2.3 miliardë.

tjetrin", thotë eksperti i ekonomisë, Arben Halili.

Sipas tij, shtetet e rajonit duhet të respektojnë marrëveshjen CETA për tregti të ndërsjellë të lirë, e që në fakt synon krijimin e një tregu të përbashkët rajonal drejt integritimit në tregun e madh evropian. Njëherësh, qëllimet kryesore të kësaj marrëveshjeje janë liberalizimi dhe zgjerimi i tregut, përafrimi me rregullat e BE-së dhe integrimi gradual në Bashkimin Evropian.

Halili më tej sqaron se e vetmja rrugëdalje e fermerëve në rajon, jo vetëm në Maqedoni, por edhe më gjerë, është prodhimitaria sa më

konkurruese në treg.

"Fermerët në Maqedoni në radhë të parë duhet të shikojnë marrjen me bujqësi si profesion primar dhe jo sekondar që siguron të ardhura shtesë. Ato, gjithashtu duhet të orientohen të rrisin sasinë dhe cilësinë e prodhimeve të tyre me qëllim që nesër të arrijnë edhe çmime më të leverdishme në treg", shton ai. Në ndërkohë, edhe përfaqësuesit e bizneseve nga Kosova nuk e kanë mirëpritur vendosjen e barrierave të ndryshme për tregti të lirë në rajon. Vendimi për aplikimin e masës mbrojtëse për pemë dhe perime, sipas një analize që bëri javën e kaluar Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), tregon se kjo masë jo vetëm që ka çrregulluar tregun vendor, por ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në çmimin final të produkteve për kompanitë përpunuese dhe tregtare, lënda e parë e së cilave bie në kategorinë e produkteve të mbrojtura.

Për më tepër, Oda Ekonomike e Kosovës thotë se edhe sipas të dhënave të siguruar nga Dogana e Kosovës lidhur me importin e pemëve dhe perimeve për vitin 2018, del se vendimi në fjalë nuk gjen arsyeshmëri as nga ky aspekt, pasi nuk është raportuar rritja e importit.

"Edhe statistikisht tregojnë se nuk ka pasur vëllim të shtuar të importit për pemët dhe perimet me çka edhe vihet në pikëpyetje nevoja për këtë masë mbrojtëse, së paku jo kaq të shpejtuar dhe pa konsultime paraprake me palët e interesit. Sa për ilustrim, si rezultat i masës mbrojtëse, importi për vitin 2018 për ditët gjatë së cilës është aplikuar masa, krahasuar me ditët e njëjta në vitin 2017, ka shënuar një rënie të lehtë prej 40.000 euro", thuhet në analizën e OEK. Ndryshe, eksporti i pemëve-perimeve nga Maqedonia në Kosovë vetëm në periudhën janar-qershor të këtij viti është 2.5 miliardë denarë.



Shkup, 8 korrik - Në Buxhetin e Maqedonisë ka pagesë të shkëlqyeshme të të ardhurave me realizim prej 47 për qind nga e planifikuara, ndërsa deficitin buxhetor është 0.7 për qind apo një e katërta nga i projektuari. Këtë e theksoi zëvendësministrja e Financave, Shiret Elezi duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve, duke shtuar se po

ZËVENDËSMINISTRJA ELEZI PËR PAGESAT E TË ARDHURAVE

PËRPPJEKJE PËR REALIZIM TË INVESTIMEVE KAPITALE

bëhen përpjekje që të realizohen investimet kapitale dhe në qoftë se ka nevojë do të bëhet ribalanc, për çka në Ministrinë e Financave kanë analiza të caktuara.

"Bëjmë përpjekje dhe të gjitha institucioneve u bëjmë presione që t'i realizojnë investimet kapitale në periudhën e ardhshme. Për këtë arsye bëmë edhe analiza të caktuara, nëse ka nevojë do të bëhet ribalanc i buxhetit që t'i sistemojmë atje ku ka nevojë nga shfrytëzuesit buxhetor që të reali-

zohen", theksoi Elezi. Lidhur me akuzat për huamarrjen, zëvendësministrja tha se përfundimisht me vitin 2016, borxhi publik merrte pjesë me 48.5 për qind të BPV-së ose 4.7 miliardë euro dhe se në fund të vitit 2017 borxhi i përgjithshëm publik është zvogëluar në 47.2 për qind të BPV-së.

"Në fillim të vitit 2018 ose vetëm në janar Ministria e Financave pagoi mbi 200 milionë euro borxh të marrë nga vitet paraprake, gjegjësisht pagoi kredi në

vitin 2013 nga 95 milionë euro, ndërsa gjithashtu para kohe është paguar bono", deklaroi Elezi dhe shtoi se nga viti 2008 deri në vitin 2016 borxhi dyfish është rritur ose nga 23 për qind nga BPV-ja arriti deri në vlerë rekorde prej 48,5 për qind nga BPV-ja.

Lidhur me huamarrjen e djetshme dhe shumën e lartë të regjistruar të letrave shtetërore me vlerë, theksoi se në fillim të korrikut në ankand është regjistruar shumë më e vogël nga ajo që

duhet të paguhet. "Në fillim të korrikut morëm borxh 10 milionë euro, ndërsa i kthyem 12 milionë. Kjo është pjesa që varet nga afati dhe struktura e letrave me vlerë. Nëse në vitin 2012 struktura e portfolios së letrave shtetërore me vlerë ishin 93 për qind në afat të shkurtër, dhe vetëm shtatë në afat të gjatë, tani 60 janë afatgjata dhe 40 afatshkurtra dhe me këtë e evitojmë rrezikun për rifinancim", deklaroi zëvendësministrja e Financave Shiret Elezi.

Qebapë me mish pule janë shitur si të derrit dhe viçit!

Shkup, 8 gusht - Agjencia për Ushqim dhe Veterinari (AUV) në marketet e Maqedonisë ka zbuluar mish të bluar për qebapë dhe qofte me mish pule, i cili është deklaruar si i derrit, i viçit apo i përzier (mish viçi dhe derri). Mishi është tërhequr nga shitja, ndërsa operatorët e ushqimit janë dënua me para, nga 5000 euro si subjekt juridik, përkatësisht me nga 1700 euro personat përgjegjës në kompani. Siç deklaroi për MIA-n drejtori i AUV-së, Zoran Atanasov, kontrollet janë zbatuar në maj të këtij viti, por vazhdojnë që të mbrohen konsumatorët dhe të ruhet cilësia e prodhimeve. "Te pesë operatorët me ushqim konfirmuam se nuk e deklarojnë përdorimin e mishit të shpendëve, ndërsa e vendosin në qebapë ose qofte. Tani atë e ndërpreme. Kemi bërë kontroll direkt në shitje kur për herë të parë e konfirmuam lëshimin e tillë. Kemi marrë mostra nga mishi në markete, ndërsa rezultatet që i morëm nga analiza e ADN-së për origjinën, nga cila kafshë është, ishin pozitive. U konfirmua se në ato prodhime është përdorur mishi i shpendëve", tha Atanasov. Operatorët nuk e kanë ditur se janë marrë mostra për analizën. Hulumentimi është përsëritur edhe njëherë, direkt nga linja prodhuese. Rezultatet atëherë janë konfirmuar edhe njëherë. "Kontrollet e para i kemi bërë në markete dhe vende shitëse më të mëdha sepse janë me shkallë më të lartë të rrezikut për shkak të shitjes masive. Tani shkojmë më tutje, drejt operatorëve. Por, tashmë të gjithë e dinë se bëjmë kontrolle. Atë e treguan edhe analizat e fundit në të cilat nuk ka kurrfarë treguesi për shpërdorime", sqaroi drejtori. Ai përmendi se është ndërruar mënyra e marrjes së mostrave. Së pari, siç tha, bëhen kontrolle në shitje, ndërsa pastaj tek operatori. Gjithashtu, janë zbuluar edhe prodhime në të cilat ka yndyrë me origjinë bimore, ndërsa nuk janë deklaruar. Ato prodhime janë tërhequr nga shitja, ndërsa operatori është dënua në mënyrë adekuate.

Maqedonia gjendet në vendin e tretë në listën e vendeve të Evropës dhe Azisë Qendrore sipas këtij indikator. Në këtë grup, para neve janë vetëm Turkmenistani dhe Bjellorusia, ndërsa më së miri renditet Luksemburgu, ku vetëm 1.5 nga 1000 persona janë skllavër

Nju Jork, 8 gusht - Në Maqedoni, në kushte të robërisë moderne jetojnë rreth 18 mijë njerëz apo 8.7 në 1000 shtetas të Maqedonisë janë skllavër, tregon Indeksi global i skllavërisë 2018, i përpunuar nga Kombet e Bashkuara dhe Fondacioni "Walk Free". Maqedonia gjendet në vendin e tretë në listën e vendeve të Evropës dhe Azisë Qendrore sipas këtij indikator. Në këtë grup, para neve janë vetëm Turkmenistani dhe Bjellorusia, ndërsa më së miri renditet Luksemburgu, ku vetëm 1.5 nga 1000 persona janë skllavër. Sa i përket përgjigjes së Qeverisë në lidhje me këtë problem, Maqedonia është vlerësuar me BBB.

"Qeveria i miraton zbaton komponentët kryesorë të përgjigjes gjithëpërfshirëse në disa forma të robërisë moderne, ofron shërbime për mbështetje të viktimave, ka përgjigje të fuqishme ndaj autoriteteve gjyqësore, ka dëshmi për koordinim dhe bashkëpunim dhe mbrojtje për popullatën në nevojë. Qeveritë mund të fillojnë të përballen me problemin e robërisë në procedurat lidhur me furnizimet publike apo tek subjektet afariste në territorin e tyre. Mund të ekzistojnë dëshmi se disa politika qeveritare dhe praktika mund të kriminalizojnë apo rezultatet gjatë

INDEKSI GLOBAL I SKLLAVËRISË

18 MIJË NJERËZ JETOJNË NË KUSHTE TË ROBËRISË MODERNE



deportimit të viktimave", theksohet në sqarimin për atë çfarë domethënë nota BBB. Rezultatet nga raporti në nivel botëror, tregojnë se më shumë se 40 milionë për momentin jetojnë në një lloj robërie, ndërsa më së shumti në Azi dhe Afrikë. Por njerëzit në robëri jetojnë në pjesë të botës ku ajo nuk pritet, siç është SHBA-ja, ku në kushte robërie jetojnë rreth 400 mijë njerëz.

Fondacioni "Walk Free" thekson se edhe më tej nuk ekziston definicion ligjor gjithëpërfshirës për robërinë apo skllavërinë moderne, por se shprehja përdoret për përshkrimin e rrethanave specifike të cilat konsiderohen si kyçe për njohjen e robërisë në botën e sotme. Robëria moderne është e vendosur duke i marrë parasysh kriteret në vazhdim: kontrabandimin e njerëzve, punën e dhunshme, robërinë e definuar me Konventën ndërkombëtare për robëri nga viti 1926, robëria e borxhit,

martesë e dhunshme dhe puna e fëmijëve.

Vlerësimet në studim bazohen në statistika të ndryshme zyrtare në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar, por edhe me biseda me më shumë se 70.000 njerëz. Të dhënat nga Raporti tregojnë se 71 për qind nga robërit modernë janë gra, ndërsa 29 për qind janë burra. Më shumë se 15 milionë njerëz janë në martesë të dhunshme, që paraqet formë të robërisë, ndërsa rreth 25 milionë janë detyruar të punojnë pa pagesë, liri të lëvizjes dhe të drejtat themelore të njeriut.

Kur bëhet fjalë për shtete konkrete ku numri i madh i njerëzve jetojnë si rob në vendin e parë gjendet Koreja Veriore, më pas vijojnë Eritrea, Burundi, Republika e Afrikës Qendrore dhe Afganistani. Kur bëhet fjalë për shtetet arabe, problem paraqet mungesa e të dhënave relevante, edhe pse ekzistojnë raporte të shumta në media për punë të robërve, por edhe

fakti se atje punojnë më shumë se 17 milionë punëtorë të huaj në kushte të këqija. Puna e robërve, gjithashtu, është mjet i rëndësishëm në ekonominë botërore për çfarë dëshmojnë edhe të dhënat e vendeve anëtare të G-20 për një vit kanë importuar mallra të prodhuara nga puna e robërve me vlerë prej 354 miliardë dollarë. Befason fakti se lap-topët gjenden në vendin e parë në listën e produkteve të krijuara fal punës së robërve. Pas tyre vijojnë rrobat, ndërsa në vendin e tretë janë peshqit, më pas kakao dhe kallam sheqeri, gjegjësisht sheqeri. Përfundimi i Fondacionit është se është tronditëse se sa robëria moderne është e shpërndarë në shtete të ndryshme të botës. Evropa është e ndarë në bazë të asaj që në të robëria moderne më së paku tolerohet, si dhe se autoritetet reagojnë shpejt ndaj dukurive të tyre dhe sjellin ligje të përshtatshme për luftë kundër robërisë moderne.

Ulen shpenzimet e kredive të shpejta

Shkup, 8 gusht - Ulen shpenzimet e larta për kreditë e shpejta, të cilat i japin shoqëritë financiare, por edhe një bankë. Me ndryshimet ligjore që i përpiloi Ministria e Financave, shpenzimet e përgjithshme vjetore për kredi konsumatore kufizohen në 55 për qind nga kredia, të cilat deri tani arrinin madje deri 500 për qind nga shumata e kredisë. Me ndryshi-

met përfshihen kredi të vogla nën 200 euro që paraprakisht, nuk janë përfshirë me ligj. Ndryshimet e Ligjit për mbrojtje të konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore, të cilat prej sot do të ekspozohen edhe në Regjistrin e Vetëm Elektronik Kombëtar - ENER, u prezantuan në takim mes zëvendësministres së Financave Shiret Elezi dhe

kryetares së Organizatës për Mbrojtjen e Konsumatorëve Marijana Lonçar. "Që t'i mbrojmë qytetarët, ndërsa njëherësh ta ulim edhe rrezikun nga përkeqësimi shtesë i gjendjes së personave të cilët kanë probleme me pagesën e kredive, i bëmë këto ndryshime ligjore. Gjithashtu ato ulin edhe shpenzimet e përgjithshme për kreditë. Me ndryshimin e ligjit,

tani shpenzimet e përgjithshme të kredisë janë limituar në 55 për qind, apo pesëfish në normën e interesit ndëshkues prej 11 për qind. Për krahasim paraprakisht nuk ekzistonte limit, kështu që dhënësit e kredive për shumata të vogla dhe afate të shkurtra kohore kanë paguar për dyfish apo trefish shumë më të lartë të kryegjësë", deklaroi Elezi

Pastruesit më të kërkuarit për punësim

Shkup, 8 gusht - Mirëmbajtësit e higjienës të hapësirave banesore dhe afariste janë profesionit më i kërkuar për punësim. Në Byronë për punësim në vend sipas informatave të tyre kërkohen 1363 mirëmbajtës të higjienës. Mes më të kërkuarve janë edhe shitësit për të cilët ka pasur konkurs për

366 punësime, rrobaqepësit e tekstit 220, kamerierë 193, shoferë taksie 192, rrobaqepës 165, punëtorë të përgjithshëm 134, punonjës sigurimi 120, kontrollorë dhe produktet të ngjashme 99. Kërkohen edhe 99 programues, 92 kuzhinierë, 90 punëtorë magazine, 77 nëpunës administra-

tivë, 77 banakierë, 73 arkëtarë, 58 shoferë të kamionëve, 57 bravadreqës, 51 drejtues të makinës për paketim, 46 furrtarë, 44 administratorë, 44 drejtues të makinës për bulmete, 40 punëtorë për ndërtime të larta, 38 shpërndarës për shitje me pakicë, 37 punëtorë ndërtimi dhe 35 asistentë-kuzhi-

nierë. Vende të lira pune sipas të dhënave të Byrosë për punësim janë mbi 5000. Më shumë vende të lira pune ka në Shkup, 3.516, pason Vinica me 511, Koçani me 142, Kumanova me 113, Manastiri me 107, Strumica me 107, Tetova 95... Numri i personave të papunë në muajin korrik 2018 është 95.421.

Më shumë ka në Shkup 15.836, pason Tetova 11.469, Prilepi 6820... Të papunë, më me numër janë ata pa arsim - 41.628, me arsim jo të plotë të mesëm 13.240, me arsim të mesëm janë 26.584. Të papunë me fakultet të kryer janë 11.495, magjistra 909 dhe 33 doktorë të shkencave.

Gjatë muajit shtator pritet të përfundojë rinovimi i blloqeve B dhe D (investimi prej 162 milionë denarë), si dhe rindërtimi i plotë i konviktit "Goce Dellçev" në Shkup, që është më i madhi në vend. Ndërsa vitin e ardhshëm është planifikuar të vazhdohet me rindërtimin e konvikteve të mbetura dhe dinamika do të caktohet sipas fondeve në dispozicion, sqaroi ministri Ademi

Koha

Remzije BILALI

KUSHTET E BANIMIT TË STUDENTËVE

KONVIKTET U NGJAJNË STALLAVE



Shkup, 8 gusht - Shkupi, me mbi 6500 studentë nga të gjitha qytetet e Maqedonisë, llogaritet si qyteti me numër më të madh konviktesh studentore. Por, kushtet e këqija higjienike po krijojnë një ndjenjë jo të mirë të studentët dhe kjo gjendje po bartet nga gjenerata në gjeneratë. Problemet me konviktet ekzistojnë disa vite me radhë dhe kjo problematikë filloi të trajtohet nga postimi i disa fotografive nga ana e studentëve.

Përkundrejt premtimeve politike e institucionale, është punuar shumë pakë në këtë drejtim dhe studentët edhe pas diplomimit me të drejtë ruajnë kujtime të këqija nga koha e studimeve, pikërisht në saje të kushteve që i hasin në konviktet ku ata banojnë.

Ambiente në kufijtë e havarisë, lëvizja e gjallesave të ndryshme nëpër dhoma dhe në kuzhinë, ku dominojnë minjtë, kurse në ushqime mund të gesh edhe insektet, janë disa nga segmentet dëshpëruese që e bëjnë jetën e studentëve të mërzitshme në këto konvikte.

Kohëve të fundit u gjetën edhe gjarpërinj në konviktin studentor "Stefan Naumov-Stiv", kurse fotografitë të cilat po qarkullojnë nëpër rrjetet sociale, të publikuar nga ana e studentëve janë pasqyra më e mirë që shfaqin mënyrën e të jetuarit në këto konvikte.

Studentët çdo ditë e më tepër raportojnë për kushtet skandaloze në të cilat ata hasin. Ata thjeshtë ndjehen të rrezikuar dhe të pambrojtur. Në anën tjetër, Ministria e

Arsimit dhe Shkencës (MASH) thotë se do të vazhdojnë investimet për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në të gjithë Republikën e Maqedonisë, në mënyrë të barabartë, duke u fokusuar në përmirësimin e kushteve në shkollat fillore dhe të mesme si dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe qëndrimin në konviktet studentore. "Lidhur me konviktet, gjatë këtij muaji do të fillojmë procedurën për blerjen e mobilieve të reja për 18 konvikte me vlerë prej 50 milionë denarë, do të blihen shtretër, dyshekë, tavolina, karrige, rafte, jastëkë, mbulesa", deklaruan për gazetën KOHA nga MASH.

Ndërkaq ditë më parë ministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi në një konferencë për shtyp ka

informuar në lidhje me investimet aktuale dhe të planifikuara kapitale për të cilat kjo ministri ka dhënë fonde për zbatim. Gjatë muajit shtator pritet të përfundojë rinovimi i blloqeve B dhe D (investimi prej 162 milionë denarë), si dhe rindërtimi i plotë i konviktit "Goce Dellçev" në Shkup, që është më i madhi në vend. Ndërsa vitin e ardhshëm është planifikuar të vazhdohet me rindërtimin e konvikteve të mbetura dhe dinamika do të caktohet sipas fondeve në dispozicion, sqaroi ministri Ademi. Lidhur me mirëmbajtjen e konvikteve, Ministria e Arsimit dhe shkencës për gazetën KOHA thotë se ky segment është përgjegjësi e administratës së konvikteve studentore. "Reagimet në të kaluarën ka pasur

për tre konviktet më të mëdha studentore në Shkup, nën udhëheqjen e Qendrës Shtetërore të Studentëve - Shkup, me udhëheqësinë e të cilës jemi në kontakt të vazhdueshëm, në drejtim të sigurisë së vazhdueshme dhe mirëmbajtjen e nevojshme dhe kushteve të përshtatshme për akomodimin si dhe shfrytëzimin e shërbimeve si në aspektin e ushqimit gjithashtu dhe atë higjienike por edhe në të gjitha kushtet tjera të domosdoshme për studentët si, interneti, vende për rekreim dhe të ngjashme", informojnë nga MASH.

Studentët kërkojnë realizimin e këtyre premtimeve dhe përmirësimit të kushteve primare, mbi të gjitha përmirësimin e higjienës dhe ushqimit.

"Në përgjithësi kushtet në konviktet shtetërore në Maqedoni afërsisht janë të ngjashme. Mirëpo në konviktin ku kam qëndruar një vit, në "Pellagonija", edhe pse është rikonstruktuar vitin e fundit me ndërrim të dritareve, sërish nuk mund të flasim për kushte të mira banimi, sepse mungojnë dhe shumë gjëra të tjera të cilat janë elementare për banim. Sa i përket cilësisë së ushqimit, shpesh herë kundërmonte erë e keqe, kemi hasur disa herë minj në kuzhinën e konviktit. Gjithashtu gjatë dimrit nuk kemi ngrohje të mjaftueshme të dhomave dhe ujë të nxehtë për pastrim", thotë studenti Z.M nga Kumanova.

PARREGULLSI NË STACIONIN TRENAVE DHE AUTOBUSËVE

VALIXHET, PENGESË PËR TË MOS VIZITUAR SHKUPIN

Në Shkup është një stacion i përbashkët i trenave dhe autobusëve, mirëpo udhëtarët janë të hendikepaur të vizitojnë qytetin, për arsye se nuk kanë ku t'i lënë valixhet. Mungesa e shërbimeve, e bënë këtë stacion të refuzohet nga turistët



Shkup, 8 gusht - Udhëtarët që vijjnë me autobus apo me tren në Shkup, mund të ballafaqohen me një problem jo të vogël. Ata nuk kanë ku t'i lënë valixhet, poqese dëshirojnë të kalojnë disa orë jashtë objektit të stacionit, që është i përbashkët edhe për autobusët dhe për trenat. Askund nuk ka tabelë, shenjë apo ndonjë tregues që jep informacion në lidhje me ndonjë vend për t'i lënë çantat e udhëtimit. Udhëtarët rrëfejnë përvoja të ndryshme, por që të gjithë kanë të përbashkët për-

vojën jo të mirë, sidomos për ata që vijjnë për herë të parë në Shkup dhe që duan të kalojnë disa orë në qytet për të vizituar vendet kulturore-historike.

"Pas disa vitesh erdha nga Australia në Manastir tek të afërmit e mi dhe kemi rënë dakord me nënën time edhe ajo të vijë nga Sllovenia dhe pastaj të kthehem bashkë edhe me motrën time për të shkruar në pushime. Pas disa ditësh qëndrim në Manastir me shokë, erdhëm me makinë në Shkup, na la në stacionin e trenit në mëngjes

ndërkaq treni për në Lubjanë duhej të nisej në ora 22 të mbrëmjes. Ju thashë të linim valixhet dhe të shëtnim nëpër qytet që ta shihnim qytetin e Shkupit si është ndërtuar tani, dhe më pas në ora dy ose tre të shkojmë të shohim të afërmit në Kisella Vodë. Por isha e habitur kur më thanë në stacionin hekurudhor se nuk kisha ku të lija valixhet. Pastaj pyeta në stacionin e autobusit dhe ata më thanë se mund t'i lija për 50 denarë për një valixhe. Përsëri u habita nga kjo që dëgjova, është thjesht një shërbim që i duhet

udhëtarëve", rrëfen një udhëtare për gazetën tonë. Ndërkohë, nga "MZ-transport- Hekurudha" thonë se dhoma ku mund të lihen çantat e udhëtarëve për një kohë të gjatë nuk funksionon si rezultat i mungesës së stafit. Kjo dhomë ka qenë aktive para 10 vitesh, por që punohet për riaktivizimin e saj.

Por, nuk janë të paktë ata udhëtarë që më prioritarë e shohin itinerarin trenave. Ata shprehen të mllefatur se shpesh herë kthehen nga sporteli pasi merrnin vesh se nuk ka tren në qarkullim deri në ndonjë destinacion të dëshiruar. Kjo ndërprerje e qarkullimit ishte më e evidente vitin e kaluar për shkak protestave për mosmarrje të rrogave që bëheshin nga ana e punëtorëve. "Nuk jam aspak i kënaqur nga ky shërbim. Disa minuta pres për të blerë biletën por nuk është askush, edhe pse kanë pauzë nuk shkruan se kur fillon dhe kur u mbaron pauza. Erdha për të provuar trenat e ri, mirëpo me sa duket nuk kam durim ende të pres. Me këtë shërbim do

të humbim edhe ato pak vizitorë që vijjnë në Maqedoni", thotë Mile Spasovski udhëtar nga Shkupi.

Ky stacion vizitohet edhe nga vizitorë të huaj të cilët për shkak shërbimit joprofesional duhet që shpesh herë të drejtohen tek stacioni i autobusëve. "Ne nuk dimë as edhe gjuhën angleze mirë. Kemi disa minuta që po kërkojmë ndihmë për të na treguar oraret e udhëtimit për në Beograd. Na e shkruan në një fletë një orar mirëpo nuk e kuptoj sa duhet, për cilën ditë është. Po shkoj të gjej dikë për të më shpjeguar ose të gjej dikë të më ndihmojë", thotë për gazetën tonë Khoa Joa, një turiste nga Kina e cila kishte ardhur për të vizituar Maqedoninë.

Ajo që mbetet si ide për t'u realizuar është se këto dhoma të bagazheve duhet të jenë të disponueshme në të gjitha stacionet e hekurudhave dhe autobusëve të qyteteve, dhe jo vetëm në Shkup. Ekzistenca e tyre do ta bëjë më të lehtë udhëtimit për udhëtarët. (R.B)

PROBLEMI ME MBETURINAT, PREMTOHET ZGJIDHJE

NË DOBROSHT S'KA KUSH I HEQ PLEHRAT

"Ky problem po zgjat për një periudhë të gjatë kohore, kështu që nënkuptohet që nuk është as hera e parë që ndodh. Është e treta herë që gati se për dhjetë ditë radhazi, nuk vijnë për të grumbulluar dhe bartur mbeturinat. Ndonjëherë ndodh që të zgjas edhe deri në 14 ditë... ka gati tre muaj që ne si banorë të këtij fshati po ballafaqohemi me këtë problem...", thotë kryetari i Bashkësisë Lokale të fshatit Dobrosht, Faredin Iseni



ten nga qentë endacak.

Banorët edhe njëherë apelojnë deri te kompania që ka për obligim grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave të ndërmarrë masat e nevojshme për mbeturinat, pasi me ardhjen e mërgimtarëve që ka ndikuar dukshëm në rritjen e fluksit të qytetarëve, është rritur edhe sasia e mbeturinave në pothuajse të gjitha lagjet e këtij fshati.

"Nevoja për zgjidhjen e problemit të mbeturinave në fshatin tonë është shumë e madhe. Problemi qëndron në vonesat që i bën kompania, e cila i bart mbeturinat dhe për pasojë - koshat me mbeturina me ditë të tëra - ndodh që edhe me javë, të qëndrojnë përpara deryve të shtëpive tona të stërmbushura me mbeturina që qentë endacak i

bartin ato. Shpresojmë që për këtë problem të gjendet një zgjidhje çfarëdoqoftë ajo, le të angazhohet ndonjë firmë tjetër, e cila do ta kryejë punën si duhet ose kjo firmë që është e kontraktuar aktualisht - le të angazhohet të punojë me kapacitete shtesë dhe të zgjidhë këtë problem njëherë e përgjithmonë", thonë banorët.

Kryetari i Bashkësisë Lokale të fshatit Dobrosht, Faredin Iseni, thotë se ankesat e qytetarëve i ka adresuar jo një herë, por disa herë në Komunën e Tearcës me qëllim që të gjendet një zgjidhje përfundimtare për këtë problem, megjithatë deri me tani nuk janë ndërmarrë kurrfarë masash, pasi kompania që është angazhuar për grumbullimin dhe bartjen e këtyre

mbeturinave, vazhdon që punën e saj ta kryejë me vonesë.

"Ky problem po zgjat për një periudhë të gjatë kohore, kështu që nënkuptohet që nuk është as hera e parë që ndodh. Është e treta herë që gati se për dhjetë ditë radhazi, nuk vijnë për të grumbulluar dhe bartur mbeturinat. Ndonjëherë ndodh që të zgjas edhe deri në 14 ditë... ka gati tre muaj që ne si banorë të këtij fshati po ballafaqohemi me këtë problem. Si kryetari i Bashkësisë Lokale ankesat e tyre i kam përcjellë në Komunë, ndërsa për herë të fundit dje isha po në komunë - është e shtata herë me radhë që shkoj atje për të denoncuar problemin me të cilin ballafaqohen bashkëqytetarët e mi, mirëpo deri më tani nuk është

ndërmarrë asnjë masë", tha Iseni.

Haki Iljazi, drejtori i kompanisë "Eko Flor", kompani kjo e angazhuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave në Komunën e Tearcës, thotë se shkak i kësaj situatë është se në këtë periudhë janë trefishuar mbeturinat në këtë komunë.

"Nuk ka ndonjë problem, por vetëm ka vështirësi në këtë periudhë, sepse është trefishuar sasia e mbeturinave nga ajo e zakonshme. Jemi të angazhuar maksimalisht të grumbullojmë mbeturinat në tërë territorin e Komunës së Tearcës. Po ashtu, vështirësi kemi sepse mbeturinat dërgohen në Shkup dhe humbim kohë, pas mbylljes së deponisë në Rusino të Gostivarit. Janë diku rreth 3000 amviseri që kanë kontratë për transportin e mbeturinave, kurse jo rrallë herë hidhen edhe mbeturina nga amviseri që nuk kanë kontratë. Po ashtu, problem është edhe hedhja e mbeturinave ndërtimore që shkakton shumë vështirësi", tha Iljazi.

Ai është shprehur optimist se shumë shpejt kjo situatë do të sanohet. Përndryshe, situatë e njëjtë paraqitet edhe në disa fshatra të tjerë që gravitojnë në Komunën e Tearcës, ku e njëjta kompani është e angazhuar për grumbullimin si dhe bartjen e mbeturinave.

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 8 gusht - Banorët e fshatit Dobrosht të Komunës së Tearcës të revoltuar ankohen se kompania, e cila është kontraktuar për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave nga ky fshat, nuk po e kryen punën si duhet, për shkak se gjithmonë mbeturinat nga ky fshat barten me vonesë, të njëjtat për disa ditë me radhë, por edhe me javë qëndrojnë në rrugë dhe tani në muajt e verës kur temperaturat shënojnë mbi 30 gradë celsius, kundërmojnë erë të keqe dhe bar-



1455 vende të lira për studentët e UNT-së

Shkup, 8 gusht - Pak më shumë se 1400 vende të lira ka Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup, ndërsa Fakulteti i Shkencave Teknike kryeson me numrin më të lartë të vendeve të lira për studentët e ardhshëm, konkretisht për vitin Akademik 2018/2019. Në këtë fakultet ka vend edhe për 440 studentë, pasuar nga Fakulteti i Shkencave Sociale me 415 studentë, ai i Shkencave Informatike - 310 studentë, Shkencat Teknologjike me 170, si dhe Ndërtimtaria dhe Arkitektura me 120 studentë. Afati i parë për regjistrim në ndonjërin nga këto Fakultete në UNT është nga 27 deri më 31 gusht, afati i dytë nga 14-18 shtator, ndërsa afati i tretë është më 25 shtator. Regjistrimi i kandidatëve, siç është paraparë në konkursin për regjistrim të studentëve, UNT e ka caktuar nga 10 shtatori deri më 01 tetor, kur edhe është data përfundimtare për t'u bërë pjesë e studimeve në këtë universitet.

Filloi asfaltimi i disa rrugëve në Gostivar dhe në fshatin Forinë

Gostivar, 8 gusht - Pas nënshkrimit të marrëveshjes kornizë me operatorët ekonomik për realizimin e projekteve infrastrukturore në territorin e komunës së Gostivarit, si dhe kompletimin e të gjithë dokumentacionit të duhur dhe marrjes së pëlqimeve përkatëse, dje ka filluar asfaltimi i disa rrugëve në Gostivar dhe në fshatin Forinë.

"Ashtu siç u paralajmërua, paraditen e sotme filluan punët ndërtimore për riasfaltimin e rrugëve të dëmtuara përqark SHF 'Goce Dellçev' në Gostivar ku do të mënjanohet shtresa e vjetër e asfaltit dhe do të vendoset asfalti i ri, si dhe i dy rrugëve në fshatin Forinë të cilat më pas bashkohen në një, respektivisht prej te ura mbi lumin Jahorka dhe prej te Mektebi në drejtim të fushave. Rrugët te shkolla kanë një gjatësi prej 1000 metra, ndërsa kostoja arrin në 12,5 milionë



denarë, ndërsa rrugët në fshatin Forinë kanë një gjatësi prej 1.100 metra me gjerësi prej 5 metrash ndërsa kostoja arrin në 10 milionë denarë", theksoi Jasin Demiri, zëdhënës i Komunës së Gostivarit. Ai shpjegoi gjithashtu se tek shkolla "Goce Dellçev" do të ndërtohet edhe te tehorët e rrugës

sepse një pjesë janë të dëmtuara, si dhe sqaroi se obstrukcione nga organet tjera nuk ka pasur dhe se bashkëpunimi është në nivel, gjë që uron të vazhdojë edhe në të ardhmen.

"Punimet janë duke vijuar sipas planit të paraparë, ndërsa qytetarët lutem për mirëkuptim dhe kujdes gjatë realizimit

të punëve ndërtimore", shtoi Demiri. Nga Komuna informojnë se nga Zyra për implementimin e projekteve se në muajt në vazhdim, deri sa të ketë kushte të volitshme atmosferike, do të realizohen më shumë projekte kapitale të parapara, për të cilat tashmë janë siguruar mjete financiare.

Kosova deklaroi Pavarësinë e saj në vitin 2008, thajse një dekadë pas fushatës së bombardimeve të NATO-s kundër shtetit të Jugosllavisë të dominuar nga Serbia. Më herët, këtë vit Kosova festoi 10 vjetorin e Pavarësisë, por shteti i ri ka ende sfida serioze përpara në rrugën e saj të ndërtimit të plotë të shtetësisë: nuk njihet nga shumë vende, duke përfshirë Kinën, Indinë dhe pesë vende anëtare të BE-së, ka numër të lartë papunësie dhe shifra të larta të varfërisë, nuk di çfarë të bëjë me numrin e madh të minoritetit serb që nuk është i integruar, si dhe akuzat të vazhdueshme ndaj përfaqësuesve pranë Qeverisë për korrupsion dhe lidhje me krimin e organizuar. Marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë, që ende thotë se Kosova është territor i saj, janë të brishta. Tensionet ishin të larta pak ditë më parë, kur ishte afati që Prishtina të ofrojë një kornizë të re veprimi për zonat me shumicë serbe. Në periudhën kur po vijon negociatat më të vështira me Beogradin, familja Lipa shpreson se për pak kohë, të paktën, festivali do të ndryshojë agjendën e lajmeve për Kosovën. Këto rreshta janë pjesë e një artikulli të botuar në prestigjiozën "The Guardian" të Londrës me titull "Babi i Dua Lipës po organizon një festival për një Kosovë paqeje dhe dashurie" (në origjinal titulli "DuaLipa's father stages music festival for 'peace-loving' Kosovo").

Ndonëse artikulli ka në fokus festivalin "Sunny Hill", që zhvillohet nga data 10 deri më 12 gusht në Prishtinë, rreshtat e mësipërm kur jepen informacione shtesë, tregojnë se çfarë impakti mund të krijohet kur ndikohet me art e kulturë.

S'ka çfarë të flitet shumë për Dua Lipën, yllin global të muzikës, por është e qartë se mund të flitet në rang botëror për një festival, ndonëse të ri, i cili do të sjellë pranë tij edhe yje të tjerë, ndër të cilët edhe DJ-in Martin Garrix. Në këtë rast bëhen pyetjet se pse këta artistë shkojnë në një vend "problematic"? Por kështu media dhe publiku botëror bën zbulime të tjera se kush janë dhe çfarë përfaqësojnë njerëzit e këtij vendi. Me vite ndjek mediat botërore, sidomos ato anglishtfolëset dhe po në këto vite, nuk më ka rënë të shoh qaq pozitivitet që na japin një brez i ri artistësh, si Dua Lipa, Rita Ora, Action Bronson apo me emrin e vërtetë Arrian Arslani, Bebe Rexha, etj. Këtu bëjnë pjesë edhe sportistët, por edhe personazhet e tjerë të shkencës e kulturës që veprojnë në nivelet më të larta, por në fusha që mbase nuk arrijnë aq masa të mëdha njerëzish në rrafsh global. Më shkojnë këtu në mendje duartrokitjet me ovacion 18 minutash për soprano Ermonela Jaho, veç pak ditë më parë.

Po të dashur, kaq i madh është impakti e fuqia e krijimtarisë, për të cilën jo gjithmonë ka mendësi të duhur për ndikimin që ka e për vëmendjen që duhet të marrë. Jo rrallë herë kam shk-

Dua Lipa

ruar dhe theksuar këtë moment. Po e bëj edhe kësaj here, sepse në historitë qeverisëse të Maqedonisë, nuk ka ndodhur ndonjëherë që dikasterin e Kulturës, në dy poste kyçe, Ministri dhe Sekretari Shtetëror, ose edhe i pari edhe i dyti i saj, të jenë shqiptar.

Tani Kultura kur është e nivelit të lartë, ajo tejkalon kufijtë etnik e të gjitha tjerat që ne dimë ti vëmë rreth vetes, por nga ana tjetër - të gjithë e dimë se që të arrijë nivelet e larta për të pasur ndikimin e përshkruar më sipër, do edhe mbështetje, por edhe vizion. Prandaj edhe përmend faktin se dy shqiptarë janë në krye të Ministrisë.

Nëse i shtrohemi edhe më gjerë kësaj teme, se çfarë ndikimi duhet të ketë politika te kultura, atëherë do të pajtohem me shumë teoricienë e artistë, ku përgjigja është se "s'duhet të ketë fare", apo "ajo duhet të jetë minimale". Por realitetet tona, e sidomos kur bëhet fjalë për fonde apo mbështetje të caktuar, e dimë shumë mirë se shumëçka kalon përmes politikës. Në Prishtinë po bëhet një festival i ri dhe po merr vëmendje të madhe botërore, në Maqedoni ne kemi disa festivale, por ato mezi po marrin vëmendjen e titullarëve e ku më të medies ndërkombëtare. Pse kjo ka rëndësi? Me rëndësi ta dinë njerëzit, do thoshin dikush. Pikërisht. Për hir të se vërtetës, yje globale të disa fushave ishin në Maqedoni, por në vendtakime dhe ndërtim urash me ta, por edhe për një

kënaqësi të rrallë, apo përvojë artistike e kulturore, disa titullarë preferojnë të fotografohen në ngjarje lokale të vogla dhe kështu në vend që ushtrojnë ndikimin e tyre tek njerëzit edhe në formë edukimi, duke u bërë edhe si model, ata krijojnë një proces të kundërt, ku theksojnë vlera shpesh të dyshimta e i nxjerrin ato në vëmendje.

Vera zakonisht është me më pak zhvillime politike, aktivitete të tjera më të "lehta" marrin vëmendje. Momenti e do që këtë verë, vëmendja të jetë te politika dhe procesi delikat i Referendumit për emrin, por një kujdes më i rëndësishëm ndaj zhvillimit shpirtëror, apo edhe për afrimit të tij me botën, nuk do ishte keq, madje e preferuar.

Nuk dua as ti hyjë debatit se nëse njerëz të duhur janë në postet e duhura, në këtë fushë e të tjera, se do pajtohem shpejtë, por duke pranuar realitetin, ata që janë aty - nuk mund të mos bëjnë më shumë. Kjo më është pak të thuhet se është e palejueshme.

Në nëntor për shembull, në Shkup, me një ekspozitë do të duhet të vijë Anri Sala. Për ata që se dinë, ai është më i madh se Dua Lipa në artin pamor global. Aq i madh është sa për ilustrim, Franca dhe Gjermania bashkë e angazhuan për të përfaqësuar dy vendet me një vepër në Bienalen e Artit në Venecia - një nga aktivitetet më të rëndësishme të artit pamor botëror. Për mos të përmendur vargun e çmimeve ndërkombëtare që ka marrë apo faktin

Yje globale të disa fushave ishin në Maqedoni, por në vendtakime dhe ndërtim urash me ta, por edhe për një kënaqësi të rrallë, apo përvojë artistike e kulturore, disa titullarë preferojnë të fotografohen në ngjarje lokale të vogla dhe pa rëndësi dhe kështu në vend që ushtrojnë ndikimin e tyre tek njerëzit edhe në formë edukimi, ata krijojnë një proces të kundërt ku theksojnë vlera shpesh të dyshimta e i nxjerrin ato në vëmendje



që ka ekspozuar në galeritë më të njohura në botë. Por, ironia është se ekspozimi i tij, që do të tërheqë vëmendjen globale të mediave, po has në vështirësi në Maqedoni. Kështu të paktën thoshin informacionet pak kohë më parë. Por çfarë do të ndodhë? Si zakonisht, entuziazmit të madh të individëve që pastaj shndërrohet në sukses, do ti ngjiten titullarë e zyrtarë që as dinë e as marrin vesh se për çfarë bëhet fjalë për të përfituar vëmendjen e për ta përkthyer në kapital politik. Ndërkohë që e kanë pasur tërë kohës dhe është dashur të bëjnë të kundërtën, të punojnë e me punë ta marrin vlerësimin aq të kërkuar, e shpesh të pamerituar.

Por realiteti është ky: individë të fuqishëm me punë sizifi që marrin vlerësime e sjellin ndikime madje dhe globale, e pastaj atyre iu ngjiten përtacët politikë që duan ca thërrime mirënjohjeje nga këta individë për ti përdorë për përfitime të vogla, kryesisht politike banale. Në këtë ekuacion, asnjëherë s'ka vizion e politika qëllim-mira e afatgjata. Por realiteti edhe më i hidhur është se, ka titullarë e zyrtarë as që marrin vesh, e as dinë asgjë, e as nuk njohin këta individët me punë sizifiane kështu që s'ke ç'të thuash më shumë. Shpresa mbetet tek njerëzit që të mësojnë vetë për kulturën e artin e për ndikimet që ajo mund të sjellë.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)



Nga
Nazim RASHIDI

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhese, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 8 gusht | Numri i parë i gazetës do të më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Mbështetësit e vegjël të ideve të mëdha



Nga
Mehmet KRAJA

Idetë kombëtare janë ide të mëdha dhe brenda tyre përpigjen të akomodohen edhe ata që i ndjejnë me krejt qenien e tyre problemet e kombit, pra patriotët e vërtetë, por edhe ata që e përdorin kombin për pushtet, për prestigj të rrejshëm, për përfitime politike, për përfitime materiale etj., sepse, siç është thënë tashmë, patriotizmi është vërtet ndjenjë fisnike, por është edhe strehë për t'u fshehur edhe horrat dhe krejt soji i tyre. Te ne, meqë tashmë kemi arritur një shkallë të demokratizimit të mendimit, të drejtën për të ndarë "etiketa" kombëtare e kanë të gjithë, edhe ata, të cilët që më shumë se njëzet vjet përdorin retorikën patriotike "bam-bam-bam!" për të heshtur oponencën, por edhe ata që në emër të kombit vërtet nuk kanë lënë gjë pa bërë. Asgjë nuk është e fshehtë dhe asgjë nuk është histori e largët. Të gjithë e dimë se çfarë ka ndodhur me ne gjatë viteve '90 dhe më herët, e dimë se kush ishim dhe çfarë bëmë: sekush punoi vërtet që punët e kombit dhe të Kosovës të shkonin mbroth; sekush u vu në shërbim të pushteteve, ideologjive, diktaturave, armiqve, madje edhe vrasësve; sekush tjetër krejt atë situatë tragjike e kaloi duke qëndruar anash, sa për shkak të bindjeve politike, sa për shkak të burracakisë dhe qyqarllëkut. Vetëm se, tamam vetëm se, e drejta për t'i ndarë këto kategori nuk i takon askujt në mënyrë eksplicite, ngase një numër historish me LDK-në tashmë janë bërë të mërzitshme, sikundër që një numër tjetër historish me UÇK-në janë bërë të pabesueshme.

1. Përveç retorikës, së cilës pakkush i beson, monopolin e argumenteve nuk e ka më askush. Midis çlirimtarëve janë identifikuar qartë një numër syresh që tashmë i kanë shitur lirë idealet e tyre të kryehershme. Midis atyre që iu bënë çlirimtarëve oponencë politike dhe ideologjike tashmë janë identifikuar qartë ata që e përdorin dhe e keqpërdorin "rezistencën paqësore". Prandaj, zhvillimi i diskutimit mbi këtë bazë, në një rrethanë të këtillë, më duket krejt i pamundur. Më duket i pamundur, sepse mua, si qytetar i Kosovës, askush nuk më jep garanci se ish-çlirimtarët, pasi kanë marrë mirënjohjen time jetësore për më shumë se njëzet vjet, disa syresh, për shkak të interesave mesquine dhe krejt personale (për të shpëtuat lëkurën e vet, pasurinë, privi-

Ideja për korigjimin e kufijve ose për shkëmbim terriroresh, nëse gjen zbatim, nuk do t'i japë Kosovës asnjë pëllëmbë nga Lugina e Preshevës, siç pretendohet, por do t'i sigurojë veriut autonomi terrirore. Me pozitën e saj aktualisht të pafavorshme, Kosova e politikës reale, jo e retorikës folklorike, nuk do të jetë në gjendje të imponojë as zgjidhje simetrike të Luginës së Preshevës me asociacionin e komunave serbe, e jo më ndonjë gjë më shumë se kaq



legjet e pushtetit etj.), tani do të jenë në gjendje të kërkojnë dhe të gjejnë një zgjidhje të përshtatshme për Kosovën edhe atje ku ajo nuk është, sepse jemi dëshmitarë se një numër syresh, në mënyrën më të pashembullt e kanë konvertuar në pushtet idealin e tyre dhe idealin tonë të lirisë. Sepse, është e ditur, disa pasione të ulëta njerëzore dalin në shesh pikërisht atëherë kur heshtin armët. Gjithashtu, askush nuk më jep garanci se partia politike, në themelimin e të cilës kam marrë pjesë dikur, pra LDK-ja (aq më bën se qenka regjistruar në Beograd, le të mos ia japin votën, pra!), pasi e ka keqpërdorur dhe e ka manipuluar "rezistencën paqësore" gjatë viteve '90 dhe ka bërë pazare nga më të pamundshmet për pushtet, tani, duke luajtur lojën e strucit, nuk është në gjendje të marrë përgjegjësi as papërgjegjësia e vet. Dhe askush nuk më jep garanci se në mbrojtje të kësaj kauze do të qëndrojë Lëvizja "Vetëvendosje!", sepse ajo, ose një pjesë e saj, pasi i trulloshën kosovarët me ideale të rrejshme, në ballafaqimin e parë me pushtetin e humbën toruan dhe u bënë pikë e pesë, duke mbetur pa identitet dhe integritet. Besimin tim nuk e ka as Shqipëria, qoftë e socialistëve apo e demokratëve, sepse, përveç mësimëve tragjike të historisë më të hersh-

me, në memorien tonë kemi të regjistruar aq shumë raste të abuzimit me "solidaritetin vëllazëror" ndaj Kosovës, sa ndonjëherë nuk na bëhet t'i themi të gjitha. Si mund t'i besohet Shqipërisë, se do të qëndrojë e paepur (!) në mbrojtje të interesave të Kosovës, kur po kjo Shqipëri, për interesa aq mesquine helmon popullin e vet me miell për kafshët që importon nga Serbia? Si mund t'i besohet kësaj Shqipërie, që një ditë vë kufij e një ditë tjetër heq kufij me Kosovën, që një ditë vë dogana e ditën tjetër heq dogana, kur as patatet e Kosovës nuk i lejon të hyjnë në tregun e saj? Dhe, ç'garanci mund të kem se një Shqipëri e këtillë i mbron interesat e Kosovës, kur Presidentja e Kroacisë, znj. Grabar-Kitarović, më 19 korrik 2018, gjatë një fjalimi në Kuvendin e Shqipërisë falënderoi shqiptarët për kontributin që kanë dhënë për lirinë e vendit të saj, një kor i tërë mediesh dhe politikanësh, të hidhëruar e të zemëruar, e të shastisur se mos po lëndohet Serbia, dalin e pohojnë solemnisht: asnjë shqiptar nuk ka luftuar dhe as ka derdhur gjak për lirinë e Kroacisë! Po kosovarët? Ah, po, ata janë tjetër gjë! Rolin e të tillëve duhet mënjënuar sa më parë nga çdo agjendë politike me parashenjë kombëtare.

2. Në një rrethanë kësisoj, kur ekziston një shkallë e këtillë relativiteti, e vetmja zgjidhje është të jesh skeptik dhe të mos i besosh askujt. Dhe kur idetë e mëdha të kombit gjejnë mbështetës kaq të vegjël, si në këtë rast, dhe kur vetë idetë janë në rrezik të madh të degjenerojnë në tërësinë dhe kuptimin e tyre, e vetmja zgjidhje është t'i besosh mendimit kritik dhe askujt tjetër. Dhe ky mendim kritik thotë se nuk kishte asnjë arsye që çështja e ndarjes apo mosndarjes së Kosovës, e ndërrimit të terrirore ose e korigjimit të kufijve, quajeni si të doni, të hapej pikërisht në këtë kohë dhe në këtë rrethanë. Ky mendim kritik nuk e pranon se Serbia, nga një shtet që ka ushtruar gjenocid mbi popullin tonë, si me magji u bëka e butë si qengj, e fisme dhe zemërgjerë, sa të pranojë t'i jepet Kosovës edhe Lugina e Preshevës, edhe veri i Kosovës. Ç'janë këto tullumbace politike që hidhen në eter me kaq naivitet ose djallëzi? Kush e beson këtë patriotizëm të rremë? Që sa vjet zhvillohen bisedime në Bruksel dhe mezi janë arritur ca marrëveshje të mjera praktike, të cilat,

për shkak të refuzimit arrogant dhe të vazhdueshëm të Serbisë, nuk gjejnë dot zbatim në terren. Mendimi kritik nuk e pranon idenë se me Serbinë, Kosova do të bëjë shkëmbime paqësore të terrirore, ndërsa kjo thuhet pikërisht tani, kur në kalimet kufitare Kosovë-Serbi, bashkatdhetarët tanë, të shëndoshë dhe të sëmurë, me fëmijë të vegjël dhe të rritur, pasi të kenë bërë 40 orë udhëtim nga vende të ndryshme të Europës, presin edhe nga pesë orë të tjera për ta kaluar këtë kufi të mallkuar. Kush mund t'i besojë këta zotat tanë të politikës, se do të bëjnë gjëra kaq të madha, siç është korigjimi i kufirit me Serbinë, pa humbur Kosova asnjë pëllëmbë tokë, kur ata, që njëzet vjet e kënde, nuk janë në gjendje ta detyrojnë Serbinë të zbulojë varrezat masive dhe t'i kthejë eshtrat e të pagjeturve? Poryryma, po fusnota, po përfshirja e Kosovës në organizata ndërkombëtare, po FSK-ja, po ndërrimi i kushtetutave, të Kosovës dhe të Serbisë? Dhe, derisa zotat tanë të politikës dhe frymëzuesit e tyre tjerin ëndrra ose gënjejnë në mënyrën më të paskrupullt për marrëveshje historike me Serbinë, është po kjo Serbi që e nderon, e lutë, i bën respekt dhe koncesione secilit shtet që nuk e njih ose e tërheq njohjen e Kosovës.

Po vetë Kosova a i ka pozitë atë që fuqishme, sa të imponojë marrëveshje të favorshme me Serbinë? Nga ajo që shihet, që e dinë qytetarët e Kosovës, jo që jo: liderët kryesorë të Kosovës pritet të akuzohen nga një gjykatë ndërkombëtare; ekziston perceptimi i bashkësisë ndërkombëtare se në Kosovë krimi i organizuar dhe korrupsioni bën kërdrinë; reformat në të gjitha fushat kanë ngecur dhe askush nuk flet më për to; investimet e huaja kanë pësuar rënie dhe ekonomia nuk premton ditë më të mira. Përveç kësaj, qytetarët e Kosovës e dinë fare mirë se liderët e saj politikë të të gjithë krahëve dhe ngjyrave janë të varur nga sponsorë, të cilët ditën shesin patriotizëm për Kosovën, kurse gjithë natën bëjnë tregti dhe kontrabandë me Serbinë. Një Kosovë e këtillë nuk është për mburrje dhe, natyrisht, nuk mund t'i bëjë karrëshillë askujt, që domethënë se pozita negociuese e Kosovës dhe e atyre që i bëjnë negociatat është krejt përtokë. Pra, Kosova nuk i ka kryer detyrat e saj, ato detyra që i ka marrë përsipër ndaj qytetarëve të saj dhe ndaj bashkësisë ndërkombëtare, për t'u bërë një

shtet i respektuar dhe kredibël. Tani për tani Kosova nuk ka potencial real që të imponojë zgjidhje, as për çështjet më ordinere, jo më për të tilla që tronditin kontinentin. Me pozitën e saj aktualisht të pafavorshme, Kosova e politikës reale, jo e retorikës folklorike, nuk do të jetë në gjendje të imponojë as zgjidhje simetrike të Luginës së Preshevës me asociacionin e komunave serbe, e jo më ndonjë gjë më shumë se kaq. Sepse është po kjo klasë politike e Kosovës, e cila nuk ka arritur të imponojë përfshirjen e Luginës në asnjë agjendë politike ndërkombëtare, as në bisedimet e Vjenës, as Pakon e Ahtisaarit, as në bisedimet e Brukselit.

3. Së fundi, a ekziston vërtet një përkrahje ndërkombëtare për një marrëveshje të mundshme të Kosovës me Serbinë, edhe për shkëmbim terriroresh, ose korigjim kufijsh, siç pretendohet tani? Sigurisht që po, sepse është parim themelor i politikës ndërkombëtare të pranohen të gjitha marrëveshjet që janë paqësore dhe që nuk cenojnë palën e tretë. Mirëpo, kjo është një hipokrizi e shkallës shumë të lartë, nëse një parim ndërkombëtar afishohet si ndërrim i politikave të atyre vendeve që e bënë pavarësinë e Kosovës. Më anë tjetër, mendimi kritik të bën të dyshosh se me një lojë të këtillë terriroresh Serbia nuk synon as të japë Luginën e Preshevës, as të mbajë veriun e Kosovës, por të hapë kapitullin e ristrukturimit të Bosnjës, sepse atje ajo synon të dalë e fituar. Po me Maqedoninë, e di kush se çfarë do të ndodhë pastaj?

Megjithatë, larg retorikës patriotike të llojit "bam-bam-bam!", përveç faktorizimit politik të ndonjë individi, a pritet të ndodhë diçka që ia vlenë gjithë këtë zallamahi dhe frustrim politik të opinionit? E kam thënë dhe do ta përsëris: pa mëdyshje, kjo është kauzë e Serbisë, sepse vetëm ajo mund të dalë e fituar në këtë rrethanë, jo me ndonjë shkëmbim terriroresh as korigjim kufijsh, por thjeshtë me një asociacion të komunave serbe, me kompetenca ekzekutive dhe me shtrirje të përkufizuar terrirore, i cili, nëse pranohet si i tillë, rrezikon seriozisht ta defunksionalizojë shtetin e Kosovës. Si kompensim për këtë koncesion të madh që mund t'i bëhet Serbisë, Kosovës mund t'i premtohet ulëse në OKB. Por çfarë do të jetë ajo ulëse? Si e Palestinës?

Për mua: Jo, faleminderit!



Theodor Morel nuk u dënua asnjëherë për krime luftime. Ai nuk ishte kurrë një person ideologjik, dhe anëtarësimi i tij në Partinë Naziste është parë si rreptësisht për përfitime personale. Ai u pasurua gjatë luftës nga thertoret dhe fabrikat që prodhonin hormonet e tij të kafshëve dhe Vitamultin. Ai fitoi para nga kontratat që furnizonin makinerinë ushtarake naziste me barnat e tij. Por në fund, mbeti pa asgjë

Nga Daniel RENNIE

Gjermania naziste ishte e drogës. Shoferët e taksive, aktorët, sekretarët, shitësit, biznesmenët kryesorë - të gjithë merrnin pilulën narkotike të quajtur Pervitin. Kjo përputhej me filozofinë naziste të epërsisë ariane, pasi vepronte si nxitësja e fundit, edhe pse artificiale, e performances së tyre të lartë.

Njerëzit punonin pa ndërprerje për orë të tëra, nganjëherë për ditë të tëra, duke zgjeruar gjithnjë e më shumë interesat e Rajhut të Tretë. Shumë shpejt, përpjekja gjermane e luftës u bazua mbi drogën. Pervitin, bëri që forcat e armatosura gjermane të ndiheshin të pamposhtura, duke marshuar për ditë të tëra, dhe të luftonin pa frikë armikun. Por kjo gjithashtu shtoi çrregullimet psikike, duke ndërtuar një ushtri dhe komb fanatikësh. Prandaj nuk është e habitshme që njeriu që udhëhiqte vendin, Adolf Hitler, drogohej rregullisht. Por regjimi i tij i përditshëm shkoi shumë përtej. Ndërsa lufta përparonte, Hitleri u bë gjithnjë e më shumë i ndërvarrur nga përafërsisht 80 drogëra të ndryshme, që i merrte gjithnjë nga mjeku Teodor Morel.

Sipas librit të Norman Ohler "Drogërat në Gjermaninë naziste", Morel ishte një oportunist i thekur. Pasi shërbeu si doktor nëpër anije, dhe pastaj një mjek ushtrie gjatë Luftës së Parë Botërore, ai vazhdoi të bëhej mjeku personal i atletëve të suksesshëm, biznesmenëve të

DOKTOR MOREL DHE E VËRTETA E PARRËFYER E DROGIMIT TË HITLERIT



njohur, dhe madje edhe mbretërve si Shahu i Persisë dhe Mbreti i Rumanisë.

Karriera e tij në Berlin, lulëzoi kur nazistët u ngjiten në pushtet. Personaliteti kompleks dhe i errët i Morel, rriti dyshimet për prejardhjen hebraike dhe pas zvogëlimit të klientelës së tij, ai iu bashkua Partisë Naziste për të shmangur mosbesimin e mëtejshëm, dhe së shpejti nisi t'u injektonte barnat të pazakonta trupave elitë SS. Në vitin 1936, Morel u takua me Fyhrerin në një darkë. Hitlerivuan nga dhimbje të forta dhe fryrja në stomak. Ai e bindi hipokondriakun Hitler, të gëlltiste kapsulat Mutaflor, të cilat përmbanin një të E.Coli të hidrolizuar dhe pilulat anti-gaz të Dr.Kusterit, që përmbanin gjurmë të strikinës.

Simptomat e Hitlerit u përmirësuan menjëherë. Së shpejti, Morel nisi t'i jepte një dozë të përditshme me Vitamultin, një pluhur misterioz që e çonte në kulm energjinë e Hitlerit. Morel kishte arritur aty ku kishin dështuar mjekët e tjerë. I bindur nga mrekullitë mjekësore të Morel, Hitleri e emëroi si mjekun e tij personal në vitin 1937. Por rrethi i brendshëm i Hitlerit, e kishte të vështirë ta pranonte. Morel ishte rondokop, vuante nga djersitja e

tepërt, halitoza dhe kishte një erë të rëndë të trupit.

E dashura e Hitlerit, Eva Braun, e cila më vonë ishte vetë një paciente e Morel, rrinte fillimisht e distancuar nga ai prej tij. Por Hitleri i tha: "Unë nuk e mbaj në punë Dr.Morel jo për erën që vjen, por kujdesin që tregon për shëndetin tim". Morel u bë shpejt hijja e Hitlerit, duke e ndjekur atë në bunkerë, takime ushtarake, në pushime dhe madje për të vëzhguar territorin e pushtuar gjatë Luftës së Dytë Botërore. Këto momente u përshkruan në ditarin gjithëpërfshirës të Morel, që ofron një dëshmi unike të shëndetit të përditshëm dhe gjendjes mendore të Fyhrerit.

Në shënimet e tij, mjeku i referohej Hitlerit si "Pacienti A", një masë paraprake për të mbrojtur fshehtësinë e Hitlerit dhe veten e tij, nëse shënimet e tij binin në duart e armiqve të tij, në rastin e vdekjes së udhëheqësit nazist. Në gushtin e vitit 1941, Hitleri u sëmur rëndë. Deri në atë moment, ai kishte marrë injeksione të përditshme të vitaminave dhe glukozës, por ato nuk bënë më efektive. Me nervozizëm, Morel nisi t'i injektore hormone kafshësh. Injeksionet ndaj Hitlerit përfshinin stimulantëtmetabolikë, hormone seksuale, ek-

strakte të bëra nga vezikulatsemi-nale, dhe prostata e demave dhe derrave të rinj.

Hitleri nuk hante mish, por kishte substanca kafshësh të injektuara drejtpërdrejt në gjakun e tij. Morel i premtoi Hitlerit "shërim të menjëhershëm", dhe teksa trupi i Hitlerit u përdor si kavie për barnat e reja që provonte, ai kërkoi doza më të larta dhe droga më të forta për të pasur një efekt. Shumë shpejt Hitleri ishte si në jerm. Nëse nuk mundej të flinte, merrte një dozë barbituratesh dhe morfinë.

Nëse duhej të qëndronte zgjuar, merrte injeksione me stimulantëgjithnjë e më të fortë. Në vitin 1943, Morel nisi t'i injektonte Hitlerit doza të mëdha opiatesh. Shëndeti i tij ishte në rënie, duke u dukur shpesh më i ngathët dhe shumë i moshuar, sipas atyre që ishin më pranë tij. Eukodali, një i afërm farmakologjik i heroinës, u bë zgjidhja e Hitlerit. Ai e bënte Hitlerin euforik, dhe me frekuencën e dozave të mëdha të injektuara, u duk se ai u bë i varur. Por së shpejti edhe Eukodali nuk do të mjaftonte. Më 20 korrik 1944, Hitleri pati lëndime të lehta nga një tentativë për vrasje në Strofollën e Ujku. Këtë herë, ai që e trajtoi Fyhrerin ishte Dr.Ervin Giesing, dhe që si një ilaç të preferuar



Sipas shënimeve të Morel, Hitleri mori një total prej 800 injeksionesh dhe 1000 doza medikamentesh të ndryshme, ndërmjet gushtit 1941 deri në prillin e vitit 1945

kishte kokainën.

Prej atëherë, Hitleri merrte çdo ditë Eukodal, të kombinuar me doza të mëdha kokaine. Aleatët nisën të bombardonin kompanitë farmaceutike, të tilla si "Merck" në Darmshtad në dhjetor të vitit 1944. Papritmas prodhimi i Eukodalit u ndal. Në janarin e vitit 1945, Hitleri mbeti pa opioide, pak para se të zbriste në bunkerin e tij të nëndheshëm. Sipas Ohler, Hitleri u shndërrua në një invalid fizik dhe mendor. Ai mbahej më këmbë nga injeksionet e tij, dhe tani substancat më të rëndësishme që e mbanin atë funksional, opioidet, ishin zhdukur. Në dëshpërim, ai urdhëroi shkatërrimin e ndërtesave dhe porteve të rëndësishme gjermane. Morel mbeti si mjek i Hitlerit pothuajse deri në fund. Në ditët e fundit të luftës, Hitleri i dha leje për t'u larguar nga Fyhrerbunker. Morel iku nga Berlina në një nga fluturimet e fundit. Pa mjekun dhe injeksionet e tij Hitleri u çekuilibruatërisht, duke i informuar njerëzit rreth tij se do të kryente vetëvrasje.

Sipas shënimeve të Morel, Hitleri mori një total prej 800 injeksionesh dhe 1000 doza medikamentesh të ndryshme, ndërmjet gushtit 1941 deri në prillin e vitit 1945. Theodor Morel nuk u dënua asnjëherë për krime luftime. Ai nuk ishte kurrë një person ideologjik, dhe anëtarësimi i tij në Partinë Naziste është parë si rreptësisht për përfitime personale. Ai u pasurua gjatë luftës nga thertoret dhe fabrikat që prodhonin hormonet e tij të kafshëve dhe Vitamultin. Ai fitoi para nga kontratat që furnizonin makinerinë ushtarake naziste me barnat e tij. Por në fund, mbeti pa asgjë. Më 1948, Theodor Morel vdiq në një spital në Tegernsee nga shkaqe natyrore. (bota.al)



Organizatave joqeveritare në Hungari janë të ekspozuara ndaj ligjeve gjithnjë e më të ashpra. Ato pengohen shpesh në punën e tyre sociale, kur mbështeten nga fondacioni Soros

ORBANI S'KA TË NDALUR KUNDËR "MERCENARËVE TË SOROSIT"

Në rrugën Molnar Nr. 19 të Budapestit merr fund në heshtje një epokë. Fondacioni Open Society-Shoqëria e Hapur i miliarderit Soros, kishte këtu selinë e tij qendrore europiane. Tani dosjet po mblidhen, kompjuterët po hiqen nga prizat, punonjësit zhvendosen. Në biseda ata përpiqen të ruajnë një ton të përmbajtur. Por të gjithë e kanë të qartë, se kjo shpërngulje shënon një ndryshim epokash.

Më 31 gusht Open Society e zhvendos qendrën në Berlin. Sipas drejtuesve arsyeja është "klima politike represive dhe ligjore në Hungari". Kështu në Budapest merr fund ajo që u fillua para më shumë se tre dhjetëvjeçarësh. Miliarderi i bursës, George Soros kishte mbështetur në vitin 1984 opozitarët antikomunistë dhe pas vitit të ndryshimit 1989, nga ky kryeqytet kishte mbështetur aktivitetet e shoqërisë civile në të gjithë rajonin e Europës Lindore dhe Juglindore. "Duhet ta theksojmë, se ne vërtet fizikisht do të jemi në Berlin, por mbështetja për rajonin nuk do të dobësohet", thotë punonjësi veterani i këtij fondacioni dhe drejtues i programit të Europës Qendrore e Lindore, Peter Nizak. "Por është e vërtetë, një kapitull mori fund".

KRIMINALIZIMI I OJQ-VE

Zhvendosja e Fondacionit Soros është edhe një tregues i presionit, nën të cilin ndodhen organizatat e shoqërisë civile në Hungari



dhe rajon. Ato janë një nga shtyllat më të rëndësishme të pavarura të kontrollit të shtetit dhe pushtetit, e me këtë një pengesë e madhe për kryeministrin, Viktor Orban. Transformimi që i bëri ai Hungarisë ka tipare autoritare dhe ecën paralelisht me korrupsionin dhe intransparencën.

Në fund të qershorit, Orban la të miratohej në parlament një paketë ligjore me ndryshime ligjore e kushtetuese nën emrin "Stop Soros", një paketë që ofron mundësi për kriminalizimin e punës së organizatave të shoqërisë civile, "kur këto mbështesin migrimin ilegal". Në të njëjtën kohë këto ligje parashohin kufizime të së drejtës së azilit, të drejtës së grumbullimit etj. Para 10 ditësh parlamenti hungarez miratoi një të ashtuquajtur "tatim të veçantë imigrimi" që nënkupton një dëbim 25% tatim për të gjitha të ardhurat e organizatave joqeveritare kur "këto mbështesin migrimin ilegal." Këto janë masat më të fundit, sepse që në vi-

tin 2014, Viktor Orban gjatë fjalimit të tij të famshëm për ndërtimin e një shteti liberal kishte bërë të ditur veprim të ashpër ndaj aktivistëve civilë.

LISTA ME "MERCENARË TË SOROSIT" NË GAZETA

Paralelisht me këto masa ligjore, organizatat e shoqërisë civile janë të ekspozuara gjithnjë e më shumë ndaj presionit. Para zgjedhjeve parlamentare në prill, gazeta proqeveritare "Magyar Idők" publikoi me gjasë raportime investigative, sipas të cilave "aktivistë të Sorosit" në Hungari donin të provokonin trazira armiqësore ndaj shtetit. Pas zgjedhjeve, gazeta e afërt me qeverinë, Figyelő publikoi një listë me 200 "mercenarë të Sorosit", mes tyre personeli i disa organizatave joqeveritare. Prej disa javësh aktivistë të Shoqatës së të Rinjve, Fidelitas të partisë së Orbanit, Fidesz mblidhen para organizatave si Amnesty International apo Helsinki dhe i mbulojnë me mbi-



Zhvendosja e Fondacionit Soros është edhe një tregues i presionit, nën të cilin ndodhen organizatat e shoqërisë civile në Hungari dhe rajon. Ato janë një nga shtyllat më të rëndësishme të pavarura të kontrollit të shtetit dhe pushtetit, e me këtë një pengesë e madhe për kryeministrin, Viktor Orban. Transformimi që i bëri ai Hungarisë ka tipare autoritare dhe ecën paralelisht me korrupsionin dhe intransparencën

shkrime në ngjyrë të kuqe - "Organizatë që mbështet migrimin".

Edhe organizata "Menedek" - Çatia që ndihmon azilkërkesit e pranuar në këtë vend u mbush me mbishkrime të tilla në qershor. Drejtuesi i saj, Andras Kovtas thotë se qeveria me qëllim prodhon në opinion "një gjendje permanente konflikt dhe lufte".

"TË ZIEJMË DERISA TË ZBUTEMI"

Se në cilat situata absurde ndodhen organizatat e shoqërisë

civile në Hungari, këtë e sheh në shembullin e fondacionit "Me Forcën e Humanizmit" - ("Az embe- riseg Erejevel"). Kjo organizatë ofron ndihma për njerëzit në nevojë në rajonin e Peçit, mes tyre edhe një qendër edukimi për fëmijët e familjeve me probleme ekonomike. Për shkak se kjo organizatë mbështetet nga Fondacioni Soros, vitin e kaluar mediat qeveritare hungareze filluan një fushatë, ku pretendonin se Soros kërkon me ndihmën e këtij fondacioni të vendosë në jug të Hungarisë emigrantët dhe bënë thirrje për të mos i ofruar kësaj organizate hapësira përdorimi.

Si pasojë fondacioni humbi një kontratë qiraje që kishte qenë e nënshkruar ndërkohë. Vërtet që para disa javësh ata gjetën hapësira të tjera, por zëdhënësi, Zoltan Mester flet për një transformim shqetësues në muajt e fundit. Njerëzit kanë frikë të japin donacione, në shkollat shtetërore ka një ndalim jozyrtar për të mos e ftuar fondacionin në aktivitete të ndryshme. "Kam përshtypjen, se me ngadalë ne duhet të ziejmë deri sa të zbutemi", thotë Zoltan Mester.

CIA ka informata se klonimi i njeriut ka ndodhur në dy laboratorë sekretë. Njëri është i bazuar jashtë kryeqytetit të Koresë së Veriut dhe tjetri mendohet të jetë në një ishull në Karaibe

Shkencëtarët e Koresë së Veriut janë duke u përpjekur të klonojnë njerëzit për ushtrinë e Kim Jong-Un. Diktatori Kim dëshiron të krijojë një ushtri, të cilët do t'i binden çdo komandë të tij. Ata kanë shpenzuar miliarda para për

PROGRAM PËR KLONIMIN E USHTRISË



një program klonimi sekret të nisur nga gjyshi i Kim më shumë se

30 vite më parë. Ekspertët e inteligjencës besojnë se tirani 35-vjeçar

dëshiron të rikrijojë gjyshin e tij, për t'i treguar popullit madhësinë e fuqisë që ai kishte. CIA ka informata se klonimi i njeriut ka ndodhur në dy laboratorë sekretë. Njëri është i bazuar jashtë kryeqytetit të Koresë së Veriut dhe tjetri mendohet të jetë në një ishull në Karaibe.

Një zyrtar i lartë i inteligjencës tha se Kim është i fiksuar me klonimin njerëzor. Ai është përpjekur të rrisë indet njerëzore, organet dhe embrionet, në këtë mënyrë mund të jetojë përgjithmonë duke bërë klone të vetes.

Serveri Sekret i Inteligjencës beson se shteti komunist ka klo-

nuar tashmë macet, qentë dhe kuajt dhe ka eksperimentuar me embrionet njerëzore për të paktën 10 vjet.

Klonimi i njeriut ndoshta është fusha e vetme e shkencës ku Koreja e Veriut kryeson botën, por çdo gjë është shumë sekrete. Në teori, klonimi i njeriut mund të prodhojë një kopje identike të një personi të gjallë, pjesët e trupit të të cilit mund të përdoren për të zëvendësuar organet si zemra, mëlçia dhe veshkat.

Edhe pse në të paktën 70 vende të botës klonimi është i paligjshëm, përsëri nuk ka asgjë që mund ta ndalojë atë.

PSE JANË TË RREZIKSHME IDETË E KORRIGJIMIT TË KUFIRIT ME SERBINË?

Logjika e shkuarjes në bisedime duke hapur çështjen e kufirit do të rrezikonte shtetin dhe të ardhmen e Kosovës, mendojnë studiuesit e Prishtinës. Ata insistojnë në respektimin e Kushtetutës së Kosovës dhe në njohjen e ndërsjellë dhe pastaj të bisedohet edhe për korrigjime dhe lëvizje të kufijve

Prishtinë, 8 gusht - Historianë dhe publicistë në Kosovë thonë se çdo hapje e temave për shkëmbim tokash apo korrigjim të kufijve në procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, është një aventurë shumë e rrezikshme që kërcënon shtetësinë e Kosovës dhe procesin historik, i cili është rrumbullakuar me pavarësinë e Kosovës.

Historiani dhe shkrimtari, Jusuf Buxhovi, thotë në një bisedë për Zërin e Amerikës se para çfarëdo marrëveshjeje ndërmjet Kosovës e Serbisë, duhet të respektohet Kushtetuta e Kosovës, të sigurohet njohja e ndërsjellë dhe pastaj të bisedohet edhe për korrigjime dhe lëvizje të kufijve.

"Askush nuk thotë që problemi i luginës së Preshevës apo veriut nuk është i rëndësishëm historike për dy popujt, por për dy popujt në mënyrë të barabartë dhe ato duhet të trajtohen por këto duhet të trajtohen gjithsesi pas një procesi kur Kosova dhe Serbia do ta njohin njëra-tjetrën si shtete. Çdo hapje e këtyre temave jashtë këtij konteksti është një aventurë shumë e rrezikshme, rrezikon shtetin e Kosovës, e rrezikon vetvetiu një proces historik i cili është rrumbullakuar me shtetin e Kosovës dhe këtu duhet të jemi shumë serioz", tha Buxhovi.

Buxhovi thotë se presidenti i Kosovës e ka filluar çështjen e korrigjimit të kufirit me mjaft zhurmë dhe në një mënyrë jokushtetuese,



pasi që, sipas tij presidenti i Kosovës nuk guxon të fillojë asnjë debat që lidhet me shkëmbimin e territoreve apo ndarjen e tyre.

"Në këtë aspekt unë mendoj se klasa politike e Kosovës duhet të sillet përgjegjshëm, gjithë opozitë e pushtet të marrin përgjegjësinë që kanë dhe jo të lejojnë që presidenti të luaj me këtë çështje apo të shtiren sikurse atyre nuk ju intereson, ky problem është shumë i rëndësishëm. Me Serbinë na pret një punë shumë e vështirë. Kosova gjithsesi sprovën e vet të shtetësisë duhet ta jap në raport me Serbinë, po ashtu Serbia edhe konceptin e saj për integrim në NATO apo Bashkim Evropian duhet pikërisht mbi këtë dhe meqë BE është njëri prej partnerëve, atëherë Kosova duhet të kërkojë maksimumin, të mbështetet me njohjen e Kosovës dhe pas njohjes t'u hyjë bisedimeve për çfarë do që lejohet mes dy shteteve por jo që këto bisedime të shkojnë në dëm të konceptit të shtetit të Kosovës dhe qenies së saj", tha ai.

Publicisti dhe shkrimtari Milazim Krasniqi, thotë se debatet për shkëmbim territoresh apo kor-

rigjim të kufijve kanë krijuar një traumë kolektive edhe në Kosovë edhe në Serbi dhe popujt e Kosovës dhe Serbisë po jetojnë në një depresion të tejzgatur për shkak të politikave të tilla.

"Politikanët kanë detyrë që të gjejnë zgjidhje të qeta dhe të gjejnë kompromise e jo të krijojnë problem përmes 'spinit' dhe aventurizmave. Kosova është bërë shtet në mënyrë të qartë dhe kufijtë ekzistues dhe kjo nuk do të duhej të hapet sepse do të dilnin problem të jashtëzakonshme. Unë jam i bindur se nëse hapet problemi i kufijve, mund të rrezikohet ndonjë version sirian për krizën e Kosovës për shkak se do të futeshin akterë të ndryshëm nga organizatat ekstremiste e deri te Rusia e akterë ballkanik, prandaj po e përcjellë me shqetësim këtë debat jo shkëmbim territoresh apo korrigjim të kufijve. Sinqerisht e kam të pamundshme ta kuptoj logjikën e këtyre avanturizmave politik", thotë ai.

Krasniqi thotë se Kosova i ka kufijtë e vet me të cilën është shpallur shtet dhe se duhet të kërkojnë zgjidhje tjera për siç

thotë rehabilitimin e serbëve lokal përmes asociacionit të komunave serbe që është edhe një detyrim ndërkombëtar i Kosovës.

Ai thotë se marrëveshja përfundimtare nuk mund të arrihet me shkëmbim territoresh ose me idenë e korrigjimit të kufijve pasi që pashmangshëm do të çonte në konflikt të armatosur.

"Ky lloj 'spini' që po bëhet për të krijuar një lloj paralelizmi meqë Serbia po kërkon veriun në ta kërkojmë Luginën e Preshevës, është diçka e rrezikshme. Do të duhej të mbylleshin këto debate dhe të bëhet një fokusim i plotë në arritjen e një marrëveshjeje lidhur me bashkësinë e komunave serbe, Kosova të mbetet shtet unitar kështu si është dhe të përshpejtohet procesi i integriteteve euro-atlantike. Ajo është rruga e vetme e Kosovës dhe Serbisë ndërsa të gjitha të tjerat çojnë në rikthim të konflikteve të viteve të 90-ta", tha zoti Krasniqi.

Edhe Buxhovi edhe Krasniqi thonë se logjika e shkuarjes në bisedime duke hapur çështjen e kufirit do të rrezikonte shtetin dhe të ardhmen e Kosovës. /VoA/

Uashingtoni inkurajon Prishtinën dhe Beogradin

Departamenti Amerikan i Shtetit i ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë që të shmangin retorikën negative dhe të punojnë së bashku për një marrëveshje që siguron qëndrueshmëri për të dyja vendet dhe rajonin. Një zëdhënës i Departamentit të Shtetit i tha Zërit të Amerikës se: 'politika e kësaj administrate është e qëndrueshme: thelbi i çdo marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të vijë nga vetë palët, njofton VOA. Ne do të vazhdojmë të mbështesim të dyja palët dhe Bashkimin Evropian si lehtësues. Kosova dhe Serbia duhet të arrijnë një marrëveshje që është e zbatueshme, e qëndrueshme dhe nuk krijon paqëndrueshmëri në asnjërin vend apo në rajon.

Kjo do të kërkojë largpamësi dhe elasticitet nga të dyja anët. Ne inkurajojmë palët që të marrin pronësinë e plotë të procesit, të ulin retorikën negative dhe të punojnë së bashku në mënyrë konstruktive'. Ditëve të fundit janë shtuar idetë e hedhura nga të dyja palët për ndarjen tokësore të Kosovës, shkëmbimin e territoreve apo 'korrigjimin e kufirit' në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Bisedimet pritet të rifillojnë në shtator dhe do të duhej të çonin në një marrëveshje gjithëpërfshirëse detyruese ligjore për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës që ka hyrë në vitin e 11-të pavarësisë dhe Serbisë që vazhdon ta kundërshtojë atë. Marrëveshja është kusht për të dyja palët që të përparojnë në rrugën e tyre drejt integritetit në Bashkimin Evropian.

THAÇI : NËSE DUHET E NDRYSHOJMË KUSHTETUTËN, E BASHKOJMË LUGINËN

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se korrigjim do të ketë, vetëm pas një pajtueshmërie të dyanshme. "Synimi nuk është ndryshimi i kufijve, është korrigjimi i tyre, kemi 400 km kufi që duhet të saktësohet me kufirin e Serbisë, saktësoi ai

Prishtinë, 8 gusht - Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi në konferencën për media u është përgjigjur pyetjeve të gazetareve rreth bashkimit të Luginës me Kosovën. Ai ka thënë se nuk po e shkel kushtetutën dhe se Kosova nuk ka pretendime territoriale ndaj askujt, por se po e kërkon bashkimin me Luginën ngase kjo është e drejt e saj. Por se ka thënë se nëse për këtë



duhet domosdo ta ndryshojmë kushtetutën, atëherë do ta bëjnë, e nëse Kuvendi nuk e miraton, do të kërkoj referendum, raportojnë me-

diat e Prishtinës.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se korrigjim do të ketë, vetëm pas një pajtueshmë-

rie të dyanshme. "Synimi nuk është ndryshimi i kufijve, është korrigjimi i tyre, kemi 400 km kufi që duhet të saktësohet me kufirin e Serbisë", saktësoi ai.

Ai ka thënë se që nga shpallja e pavarësisë, kushtetuta e Kosovës është ndryshuar tre herë dhe se kjo nuk është mëkat.

"Kosova nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë vendi, përkundrazi, por nëse duhet patjetër, do ta ndryshojmë edhe kushtetutën nëse kjo është domosdoshme.

Ajo ka ndryshu që tre herë, prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës, dhe nuk është ndonjë mëkat. E nëse Kuvendi nuk dëshiron ta bëjë këtë atëherë referendumi është

opsion i lejuar gjithashtu. Do jetë shumë e thjeshtë, do ti pyesim qytetarët nëse duan bashkimin me Luginën, po ose jo" është shprehur i pari i vendit.

Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se Asociacioni i komunave me shumicë serbe do të formohet në pajtim me Kushtetutën e Kosovës, me opinionin e Gjykatës Kushtetuese, por edhe me realitetin e krijuar në terren.

"Gjithë ky përkushtim i institucioneve të Kosovës dhe mekanizimeve ndërkombëtar, por edhe qetësia e qytetarëve në veri, bëri që të mos kemi asnjë situatë që do të mund të conte mesazh të keq për Kosovën në botë".

Tensionet e thella mes Uashingtonit dhe Turqisë po u kushtojnë rëndë tregjeve financiare të Turqisë. Lira turke pësoi rënie të fortë javën e kaluar pasi Uashingtoni vendosi sanksione ndaj dy ministrave turq. Të hënën, monedha pësoi rënie në nivel rekord pas lajmit për tarifën e reja ekonomike amerikane kundër Turqisë

PRAPAVIA E TENSIONIMEVE AMERIKANO-TURKE



Zvicra transporton ujë për lopët që po vuan nga thatësira

Helikopterët e ushtrisë zvicerane kanë filluar transportimin e ujit për mijëra lopë të etura. Kjo për shkak se ato po vuan nga një thatësirë dhe valë e nxehtë që ka goditur pjesën më të madhe të Evropës. Enë të mëdha plastike të kuqe të varura nga fundi i helikopterëve, Super Puma, bartën ujin në fermat e maleve Jura dhe në ultësirat e Alpeve, shkruan EuroNews. Autoritet zvicerane thonë se rreth 40,000 lopë kullotin në verë në kullotat e larta në kantonin e Vaudit në Zvicër perëndimore dhe se secila nga to ka nevojë deri në 150 litra ujë në ditë. Dy pellgje të mëdha sipas po këtyre autoriteteve janë mbushur me ujë për të lejuar fermerët që të mbushin kamionët e tyre. Ndërkohë dhjetëra fermerë kanë bërë thirrje për një linjë të posaçme telefonike për të kërkuar ndihmë nga helikopterët që kur operacioni emergjent u njoftua të premtën e kaluar. "Kemi pasur kesi lloj enësh për ujë, por kurrë kaq shumë," tha Gregoire Martin, i cili drejton një fermë me 68 lopë. Qeveria Federale Zvicerane dje njoftoi se do të ulë tarifën e importit për ushqimin e bagëtive dhe do të ofrojë hua pa interes për të ndihmuar fermerët të merren me thatësirën.

Ankara, 8 gusht - Mardhëniet Turqi-SHBA janë aktualisht thellësisht të tensionuara për shumë çështje për të cilat palët nuk pajtohen. Javën e kaluar, Uashingtoni ndërmori hapin e pashembullt të vendosjes së sanksioneve ndaj dy ministrave turq lidhur me çështjen e pastorit amerikan Andrew Brunson i cili mbahet i arrestuar nga autoritetet turke.

Zoti Brunson, i cili përballet me akuzat për terrorizëm ndodhet nën arrest shtëpiak. Ankaraja u hakmor me një përgjigje të ngjashme, duke i vendosur sanksione dy zyrtarëve amerikanë identitetet e të cilëve nuk janë bërë publike, raportojnë mediat botërore.

NAFTA, SI ÇAK BETEJASH

Me një Turqi importuese e rëndësishme e naftës iraniane, analistët thonë se do të jetë prioritet i Uashingtonit të bindë Ankaranë që të pajtohet me sanksionet e saj. Muajin e kaluar, zyrtarët e lartë amerikanë të udhëhequr nga marshalli Billingslea, ndihmës sekretar i Thesarit për financimet e terrorizmit, vizituan Ankaranë për t'u takuar me ministrat e qeverisë dhe drejtues biznesesh me qëllimin për të ushtruar presion lidhur me çështjen e sanksioneve.

Zoti Billingslea i vlerësoi bisedimet si pozitive, por një burim konfidencial i cilësoi takimet si të vështira.

ra.

Një burim nga bizneset turke pohoi se sugjerimi i Uashingtonit për të përdorur naftën arabë në vend të asaj të Iranit, dështoi të mos marrë parasysh çmimin e kushtueshëm dhe kohën që do t'u duhej rafinerive turke për t'u përshtatur me naftën saudite me cilësi më të dobët.

Ankaraja ka gjithashtu shqetësimet strategjike që të mbështetet tek Arabia Saudite.

"Turqisë i thuhet të blejë naftë nga Arabia Saudite, ndërsa ka një tubacion naftë me Iranin fqinj dhe mund të sigurojë naftë bruto me një çmim më të ulët", shkruan Ilnur Cevik, një këshilltar i lartë i presidentit në gazetën turke Sabah. "Përveç kësaj, kush mund të garantojë se Turqia mund të sigurojë prurje të qëndrueshme të naftës me çmime të arsyeshme kur Arabia Saudite herë pas here shfaq një politikë antagonistike ndaj Ankarasë?"

Ish-presidenti amerikan Barak Obama i bëri Ankarasë disa përgjithime kur vendosi sanksione kundër Iranit. Megjithatë kritikët theksojnë se Ankaraja i dëmtoi ashpër sanksio-

net amerikane duke përdorur arin, për të shmangur kufizimet në përdorimin e dollarëve për tregti me Iranin.

Gjatë një periudhe Turqia ishte një nga importuesit dhe eksportuesit më të mëdhenj të arit në botë. Tashmë Uashingtoni e ka mbyllur derën për të përdorur arin në tregtinë me Teheranin.

RASTI "HALKBANK"

Më parë gjatë këtij viti, një gjykatë e Nju Jorkut dënoi një zyrtar të lartë të Halkbank-it, që kontrollon nga shteti turk, për shkelje të sanksioneve amerikane ndaj iraniantit. Departamenti amerikan i Thesarit po konsideron mundësitë e vendosjes së një gjobe të majme kundër bankës, që sipas analistëve mund të jenë në disa miliarda dollarë.

Analistët e shohin përvojën e Halkbank-it si një paralajmërim për Ankaranë dhe sistemin financiar turk për rreziqet që u kanosen nëse shkelin sanksionet e ardhshme amerikane.

"Në fakt do të detyrojë Ankaranë

të zgjedhë mes Iranit dhe Shteteve të Bashkuara", tha ish-diplomati i lartë turk Aydin Selcen, i cili ka shërbyer në Uashington. "Moszbatimi i sanksioneve ndaj Iranit nuk është një opsion. Do të ketë presion në rritje nga SHBA-ja duke krijuar një rreth vicioz në marrëdhëniet diplomatike".

Tensionet e thella mes Uashingtonit dhe Turqisë po u kushtojnë rëndë tregjeve financiare të Turqisë. Lira turke pësoi rënie të fortë javën e kaluar pasi Uashingtoni vendosi sanksione ndaj dy ministrave turq. Të hënën, monedha pësoi rënie në nivel rekord pas lajmit për tarifën e reja ekonomike amerikane kundër Turqisë.

Sanksionet amerikane ndaj Iranit janë më të fundit në një listë gjithnjë në rritje të mosmarrëveshjeve mes dy vendeve.

"Në fakt mund të ketë mënyra dalje nga e gjithë kjo" thotë zoti Ozel. "Por besimi në këto marrëdhënie është zhdukur krejtësisht dhe rindërtimi i besimit në një marrëdhënie është detyra kryesore dhe më e vështirë".

Izraeli është i vetmi anëtar i OKB-së i cili kurrë nuk ka shpallur zyrtarisht kufijtë e saktë të territorit të saj shtetëror

IZRAELI IZOLON GAZËN ME PENGESË DETARE

Ministria izraelite e Mbrojtjes lëshoi fotot e para të pengesës së saj detare që synonin izolimin e mëtejshëm të Rripit të Gazës. Pengesa ndodhet në plazhin Zikkim, rreth tre kilometra nga kufiri verior me Gazën. Projekti duhet të përfundojë deri në fund të vitit 2018, dhe vlera e tij shkpn në 6.7 milion dollarë, njoftojnë mediat botërore.

Kur të përfundojë, struktura do të jetë 200-vjeçare, duke ndarë më tej Gazën nga Izraeli. Barriera do të përbëhet nga tre shtresa: një nivel baze nënujore; një platformë deta-



re e gjerë prej 50 metrash e bërë prej guri të përforcuar dhe gjashtë metra të lartë me tela me gjemba. Ministri izraelit i Mbrojtjes, Avigdor Lieberman vlerësoi pen-

gesën. "Ndërtimi i rrethimit rreth Rripit të Gazës, si në tokë dhe në det, po përparon me shpejtësi dhe me një ritëm mbreslënës. Çdo ditë që

kalon, aftësitë tona kundër terrorizmit në Rripin e Gazës janë më të forta", tha politikani i ekstremit të djathtë.

Liebermann shtoi se "Hamasi humbet aftësinë e tij për të sulmuar Izraelin çdo ditë".

Kjo iniciativë është një vazhdim i përpjekjeve izraelite për të konsoliduar rrethimin e Rripit të Gazës që nga viti 2007. Izraeli mbylli të gjitha udhëtimet tregtare dhe tregtare në dhe jashtë Gazës, dhe rreth Rripit të Gazës, duke ndërtuar një "gardh sigurie" përgjatë të ashtuquajturit "Linjat e gjelbra" (të themeluara nga armëpushimi nga viti 1949), që shërben si një kufi.

Izraeli është i vetmi anëtar i OKB-së i cili kurrë nuk ka shpallur zyrtarisht kufijtë e saktë të territo-

rit të saj shtetëror. Rreth Gazas është gjithashtu një zonë e vendosur rreth 300 metra nga rruga, brenda së cilës është e ndaluar aksesit palestinezëve, kështu që shumë familje nga ata janë të penguar të përdorin tokën e tyre bujqësore brenda zonës së ndaluar.

Ndikimi i rrethimit është i madh. Sektori industrial dhe tregtar i Rripit të Gazës ka pësuar dëmet më të mëdha për shkak të ndalimit izraelit ndaj importit të karburantit dhe gazit që çon në mungesa dhe papunësi të lartë.

Javën e kaluar, një zyrtar i lartë i OKB shprehu shqetësim në lidhje me situatën humanitare që prek fëmijët dhe shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të fëmijëve në Gaza.

KOSOVË-SERBI: PËRSE ËSHTË GAZIVODA KAQ E RËNDËSISHME?

Kërcënimi i famshëm i Vuçiqit "Unë nuk e jap Gazivodën!" jep përgjigje edhe për të tashmen. Në vorbullën e lajmeve të rreme dhe tensionit ky liqen me hidrocentralin është në epiqendër të diskutimeve



Pjesa e sistemit lidhës midis lumenjve Ibër-Lepenc është një sistem jetësor për tërë Kosovën, duke filluar me furnizimin me ujë për ujitje si dhe ftohjes së termocentralit të Obiliqit. Nëse nga njëra anë rubineti do të mbyllet, praktikisht do të paralizohej i gjithë sistemi energjetik i Kosovës

"Gazivoda" është temë e javës në Serbi së bashku me paralajmërimet dramatike nga autoritetet serbe dhe gazetave bulevardeske, sipas të cilave po përgatitet marrja arbitrarisht e objekteve energjetike e strategjike në veri të Kosovës. Që pas ndërhyrjes së njësive të NATO-s, për herë të parë në fund të rrugëve hyrëse në liqen dhe hidrocentralin e Gazivodës po duket një numër i vogël i ushtarëve të KFOR-it me argumentimin, se këto janë "stërvitje të planifikuara dhe të rregullta". Autoritetet serbe për shkak të këtyre zhvillimeve në Kosovë mbajtën takim urgjent të Këshillit të Sigurimit Kombëtar, nga ku u akuzuan opozita e disa klerikë si dhe "agjencitë e huaja" për përhapjen e thashethemeve në lidhje me incidente të mundshme në Kosovë, gjë që e bën të vështirë pozitën negociuese të Serbisë me Kosovën, thuhet nga ky takim.

Shefi i Ministrisë për Kosovë dhe Metohin Marko Gjuriç bëri një deklaratë të ngjashme një ditë më pas, kur ai theksoi se për Serbinë vija e kuqe sa i përket energjisë është tek Trepça, në hidrocentralin e Gazivodës dhe trafo-stacioni i Valaçit. Gazivoda shpesh përmendet nga autoritetet e Prishtinës, që dëshirojnë ta lidhin atë në sistemin energjetik të Kosovës. Li-

qeni si dhe hidrocentrali, bashkë me trafo-stacionin e Valaçit, janë burimet kryesore të energjetike në veri të Kosovës dhe në pronësi të Kompanisë Shtetërore Energjetike të Serbisë. Gazivoda sipas vlerësimeve arrin shifra deri më dhjetë milionë euro në vit për mirëmbajtje.

Pjesa e sistemit lidhës midis lumenjve Ibër-Lepenc është një sistem jetësor për tërë Kosovën, duke filluar me furnizimin me ujë për ujitje si dhe ftohjes së termocentralit të Obiliqit. Nëse nga njëra anë rubineti do të mbyllet, praktikisht do të paralizohej i gjithë sistemi energjetik i Kosovës. Në qershor pala shqiptare në përgatitje të dialogut teknik këmbënguli në zbatimin e Marrëveshjes së Energjisë, ndërsa pala serbe i detyronte në krijimin e Komunitetit të Komunave Serbe. Dhe nëse energjia është si çështje më e rëndësishme, atëherë Gazivoda është pjesë kyçe e zgjidhjes së këtij misteri.

ME INTERES EKONOMIK DHE KOMBËTAR

Zëvendës-kryeredaktori i revistës "Novosti" Mijat Lakiçević thotë që: "Gazivoda është e me interes të lartë ekonomik dhe kombëtar. Nga ky liqen një e treta

është në territorin e Serbisë dhe dy të tretat në veri të Kosovës. Më e rëndësishmja është se lumenjtë që mbushin liqenin vijnë nga Serbia, të cilët furnizojnë një hidrocentral që plotëson rreth gjysmën e konsumit të energjisë elektrike në tërë Kosovën". Lakiçević për DW sqaron, se çështja është më e komplikuar nga sa thuhet, se qeveria do vetëm të përfitojë nga ky burim "problem shtesë është se hidrocentrali është bërë me një kredi të Bankës Botërore marrë dhe paguar nga Serbia. Situata është e ndërlikuar sepse Kosova nga njëra anë ka të drejtë për këtë, sepse hidrocentrali është i vendosur në Kosovë dhe nga ana tjetër Serbia përsëri ka të drejtë, sepse ka investuar dhe paguar kredinë për të".

Presidenti serb Aleksander Vuçiq thotë, se tymnaja për një marrëveshjeje energjetike është një gabimi i radhës, pasi sipas tij një marrëveshje e tillë nuk ekziston aspak. Ai pretendon se qëllimi i kësaj manovre është "pushtimi" i Kosovës veriore. Vuçiq gjithashtu thotë, se autoritetet e Prishtinës kanë pasur ofertën për menaxhim të përbashkët, por ajo është refuzuar nga ata. Nëse shohim marrëveshjen e arritur në Bruksel, në sektorin e energjisë

janë vendosur linja të forta. Nga kjo theksohet nevoja për të aplikuar legjislacionin e BE-së, si dhe krijimin e një kompanie të re të energjisë për furnizimin e konsumatorëve.

Por si me gjithçka tjetër të negociuar midis Beogradit dhe Prishtinës, secila palë interpreton këto kushte të ndryshme në mënyrën e vet. Serbia konsideron se për shkak të vendndodhjes së burimeve të përmendura ajo duhet të menaxhohet nga Bashkimi i ardhshëm i Komunave Serbe dhe se kjo është në përputhje me rregulloret e BE. Pala shqiptare vlerëson se këto burime janë pronë e Kosovës dhe se duhet të menaxhohen nga Kosova.

PAKETA E KOMPLIKUAR E ENERGJISË

Teorikisht Serbia mund ta ndryshojë liqenin e Gazivodës, uji në liqen mblidhet kryesisht nga lumi Ibër, thjesht vetëm me ndryshimin e drejtimit të këtij lumi që të mos derdhet në liqen, thotë Mijat Lakiçević. "Në atë rast liqeni do të lihej pa ujë dhe Kosova pa energji elektrike. Por në këtë mënyrë e gjithë kjo mund të rrezikonte sigurinë e serbëve, që mund të ishin viktimat e hakmarrjes". Sipas bashkëbiseduesit

tonë, serbët e Kosovës që punojnë në hidrocentral, por nuk përfitojnë nga puna e bërë kjo do ishte për shkak se të ardhurat do jenë të marra nga Kompania Shtetërore Energjetike të Kosovës. "Pra këtu tani do të duhet të gjendet një zgjidhje, sepse në qoftë se hidrocentrali është i drejtuar nga diku sh i vendosur në Prishtinë, do mundet të përdoret për të lënë pas dore interesat e komunitetit serb", vë në dukje Lakiçević.

Gazivoda nuk mbetet vetëm pikë e diskutueshme për këto fakte, por edhe për problemet që sjell në furnizimin me energji elektrike në komplekset e minierave të Trepçës, gjë e cila praktikisht nuk funksionon. Një argument shtesë për zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi është mospagesa e energjisë elektrike në Kosovë, konsumatorët shfrytëzojnë situatën kaotike. Prandaj problemi me energjinë mund të zgjidhet përfundimisht vetëm në një paketë të plotë. Duke parë gjithë këtë dhe duke shikuar negociatat të lëna pas dore dhe që janë pa kompromis në mes të Beogradit dhe Prishtinës - ku marrëveshja ka vetëm që nuk ka marrëveshje - është e qartë se do të jetë e vështirë për të arritur një zgjidhje përfundimtare mbi energjinë.

"Unë mendoj se do të jetë e vështirë për të arritur vetëm një marrëveshje të përhershme për energjinë, por një zgjidhje do të ketë vetëm në qoftë se ka një marrëveshje gjithëpërfshirëse mes Kosovës dhe Serbisë", tha Lakiçević. Liqeni i Gazivodës është një shembull se si çdo çështje ekonomike politizohet dhe pastaj përdoret për politika të brendshme. Nëse ka diçka pozitive në të gjithë nervozizmin dhe alarmin rreth Gazivodës, atëherë është fakti që ky problem ka përfshirë të gjithë opinionin publik dhe se vëmendja është vendosur në kompleksitetin e situatës energjetike në Kosovë.



JETA INTIME E REMARK ME AKTOREN MARLENE DIETRICH DHE E VËRTETA E ROMANIT "HARKUT I TRIUMFIT"

Remarque gjeti forcë të shkëputet përfundimisht nga Dietrich vetëm kur kjo e fundit shkoi në Hollivud dhe ra në dashuri me Jean Gabin. Vijuan t'i shkruanin letra njëri-tjetrit deri në vdekje, ndonëse gruaja e fundit e shkrimtarit Paulette Godard i dogji të gjitha pusullat e Marlene.



-Mbase e kam shkruar vetëm për të dëgjuar një ditë zërin tuaj të mrekullueshëm teksa më thotë këto fjalë. - ia kthen Remarque duke i ndezur cigaren me një çakmak të florinjte. Strenberg, do të largohej.

Eric dhe Marlene bashkëbisedojnë gjithë natën. Vetëm në ag shkrimtari i njohur i rrëfen të vërtetën me atë zë të veshur e të thellë:

-Jam impotent.

-Oh, mrekulli...Çfarë lehtësimi. Ti nuk e di sa e urrej të bërit dashuri.



dhe pasuria që kish bërë falë romanit të vet. Një grusht njerëzish e dinin se dhjetë vjet më parë, titullin baron e kish blerë nga një finansnik. Të gjithë e shihnin me dyshim. Nga nazistët gjer tek kolegët ziliqarë për suksesin dhe historinë e tij me Dietrich.

Gjendeshin në Paris kur një mëngjes, vajza e vogël Maria do të shkonte në suitën e së ëmës për ta ndihmuar si zakonisht të vishej. Por papritur bllokohet nga dy roje përballë derës, e cila me t'u hapur shfaq një officer shtatlartë gjerman që përshëndetet me të ëmën me kërcitje takash si ushtarak. Me t'u larguar aktorja shpërthen para së bijës.

-Të kanë zënë sytë ndonjëherë skenë të ngjashme? - Si është e mundur që një burrë i edukuar si Ribbentrop të besojë ende tek Hitleri? M'u desh ta fshihja Remarkun në banjë pasi ata i dogjën

të gjithë librat e tij. Imagjino sikur ata të nëmur ta shihnin... Ç'situatë qesharake! Ua pe uniformat? Ja ku kanë përfunduar tërë rrobaqepësit hebrej. I kanë përdorur për t'u qepur kostumet. I Shko zemër dhe lajmëroje zotin Remarque...Tani mund të dalë nga banja.

Shkrimtari kishte ardhur tym e zjarr:

-Marlene... Mos guxo më të më mbyllësh me çelës. Më dëgjoje? Nuk jam një fëmijë i llastuar apo një idiot i papërgjegjshëm.

-Oh, dashuria e jetës time sa frikë kisha për ty. Ata të urrejnë sepse pikërisht, ti që nuk je hebre, braktise Gjermaninë. Ndoshta kanë ardhur këtu pikërisht për ty. Ka vetëm një arye që Hitleri m'i sjell në derë kokat e mëdha. Do të më bindë të kthehem në atdhe sepse më ka parë me zharretierë tek filmi "Engjëlli i kaltër" dhe do të fusë tek hundët ato të mbathura.

Teksa jetojnë buzë "Lago Maggiore" historia e Marlene dhe Eric vijon plot ulje-ngritje gjithmonë nëm trysinë dhe ankthin e tradhtive të saj të panumërta. Aktorja të cilën partneri i saj e thërret me përkëdheli Puma vijon aventurat ndërsa shkrimtari, një njohës i pasiqi i verërave, të dehet, aq sa shpesh ishte Marlene ajo që e kthen-te mbrapsht nga baret e Kanës apo Montekarlos për të shmangur që lajmi të përfundonte në faqet e para të gazetave.

Tradhtia e radhës me ambasadorin amerikan (ky i fundit, babai i dy vëllezërve të ardhshëm Kennedy) do të ishte pikërisht dhimbja e madhe prej nga do të merrte jetë kryevepra "Harku i Triumfit". Ku personazhi I Xhoanë Madusë do të mishëronte pikërisht aktoren gjermane.

Thesarin e përkthimit në Shqipëri na e ka lënë i madhi Robert Shvarc. Jo vetëm kaq, por mjafton të hapësh kopertinat e një sërë librash nga më mjeshtërorët të Remarque për të lexuar aty emrin e tij "Tre shokë", "Asgjë e re nga fronti i Perëndimit", "Shkëndija e jetës", "Obelisku i Zi".

Mbase kështu Eric, gjeti më në fund forcën për t'u larguar nga Marlene. Duke shkruar për të. Duke e quajtur Xhoanë. Duke i dhënë trajtat që lexojmë sot, të një gruaje rrëzëllitëse dhe magjepsëse, të heshtur e të pabesë, gënjeshtare dhe egoiste. Dhe Remarque u hakmorr. Dashnori i fundit e vret Xhoanën në mbyllje të romanit.

"Sepse dashuria nuk vdes kurrë" siç shkruan ai tek Harku "Ne nuk vdesim. Vetëm koha. Koha e mallkuar. Ne jetojmë gjithmonë."

A nuk ka të drejtë? Ndoshta po! Remarque gjeti forcë të shkëputet përfundimisht nga Dietrich vetëm kur kjo e fundit shkoi në Hollivud dhe ra në dashuri me Jean Gabin. Vijuan t'i shkruanin letra njëri-tjetrit deri në vdekje, ndonëse gruaja e fundit e shkrimtarit Paulette Godard i dogji të gjitha pusullat e Marlene. (konica.al)

Legjenda e kinemasë dhe shkrimtari i famshëm i "Asgjë e re nga fronti i perëndimit" jetuan një nga historitë më të pazakonta të të gjitha kohërave. Ndanë bashkë disa nga vitete më të errëta të historisë botërore, në një peiudhë tragjike te Europës, përfshirë këtu edhe mërgimin nga Gjermania naziste.

Do të ishte pikërisht ai, baroni Erich Maria Remarque, që atë mbrëmje të vitit 1937 do të merrte guximin i pari teksa aktorja flokë-verdhë darkonte në Venecia.

Do të ishte pikërisht ajo, Marlene Dietrich, e cila do ta ftonte më pas të ulej në tryezën e saj.

I gjithë ky etyd flirti, në restaurant. Sepse pasionet e mëdha vijnë duke ngrënë. Ajo duke darkuar me regjisorin e saj nga ku do të dëgjonte një zë që do t'i ndalte frymën:

-Zoti, Strenberg...

-E dashur, zonjë...

Kaq do të mjaftonte. Një zë burrisi i tij, për të eksituar kuriozitetin e divës dhe një puthje e përkryer e dorës së Marlene për ta ftuar të bashkohej me ta.

-Dukeni tepër i ri për të shkruar një prej librave më të bukur të historisë sonë, - i tha ajo, duke iu referuar romanit "Asgjë e re nga fronti i perëndimit" që kish parë dritën e botimit në 1929, I shkruar nga një ish ushtar i frontit.

Jo ç'do gjë shkonte fjollë. Ai kishte mbushur të 39-at dhe ajo një 36 vjeçare që vazhdonte lidhjen e kahershme me gruan e saj, Jutta; një bukuri e rafinuar shumë e ngjashme me të. Ndërsa Eric, duhet të duronte joshjen e pashershme biseksuale të aktore dhe një mish-mash situatash si më poshtë "Shkrimtari, diva, e bija me bashkëshortin e saj të cilëve u shotohej edhe Tami dashnorja depressive e të shoqit, që duronte orëçast tradhtitë e aktore" të gjitha arsye për të shpërthyer.

E, megjithatë uljengritjet e humorit të Marlene, Remarkut i jepnin një kënaqësi të papërsëritshme. Një ditë qenë zënë për më shumë se dy orë. Fill më pas, ajo me sytë gjithë lot do t'i shpjegonte se në ç'mënyrë i donte burrat.

-Nuk i dua në shtrat. Aty dua vetëm femrat.

Ishte koha kur Remark ende s'e kishte mbledhur veten nga fama

Në Egjipt vjen një tjetër zbulim i rrallë

Një projekt infrastrukturor në Egjipt u ndal, pasi punëtorët e ndërtimit gjetën një statimë të ngjashme me sfinkth gjatë rrugëve në mes të tempujve të lashtë të Karnak dhe Luxor. Punëtorët thuhet se gjetën "trup luani me kokë njerëzore".

Faqja e internetit të lajmeve Youm raportoi se statuja nuk mund të hiqej ende mbi tokë "për

shkak të natyrës së mjedisit ku ndodhet." Megjithatë, shefi i trashëgimisë kombëtare Khaled al Anani inkurajoi njerëzit që të vizitonin zonën për të parë zbulimin.

Komplekset e tempullit të Karnak dhe Luxor qëndrojnë brenda qytetit të lashtë të Thives dhe datojnë që nga viti 1400 para erës së re. Guroret e para të Luxor filluan në vend në 1884, duke çuar në një

numër zbulimesh të rëndësishme deri në vitin 1960 kur puna e gërmimit pushoi.

Mendohet se sfinks është simbol i mbretërimit në Egjiptin e lashtë. Shumë faraonë kishin kokat të gdhendura në statuja për varret e tyre për të shënuar marrëdhëniet mes Hyjninë diellore Sekhmet, një luaneshë. Sfinksit më i famshëm gjendet në Giza, ngjitur



me Piramidat e Madhe.

Zbulimi i fundit në zonën e Luxor u zhvillua në vitin 2014, kur

arkeologët zbuluan varrin e një prodhuesi egjiptian birre, i cili jetonte 3200 vjet më parë.

ЦЕНТРАЛЕН РЕГИСТАР НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

SHKUP
Numër.04-1172/2
07.08.2018

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" nr 167/2015- teksti i pastruar, 27/2016 dhe 120/2018) dhe neni 5, 6 dhe 7 nga Marrëveshja kolektive e Regjistrat qendror të RM numër 01-866/1 të datës 01.06.2018 dhe neni 24 paragrafi 1 pika 2 e Statutit të Regjistrat qendror të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" nr 45/2007 dhe 208/2015), ndërsa në lidhje me Vendimin për nevojën e themelimit të marrëdhënies së punës numër 04-1172/1 të datës 07.08.2018, Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë shpall:

SHPALLJE PUBLIKE

Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë ka nevojë për të themeluar marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar me 34 (tridhjetë e katër) realizues për vendet e punës në vijim me kushte të veçanta edhe atë:

- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Shkencat letrare më së paku 180 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale me ose pa përvojë pune në profesion, për vendin e punës Punëtorë-korrespondent profesional dhe pagesa themelore 33.776,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Shkencat Juridike, Ekonomike apo Shkenca për letërsi më së paku 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku tre vite përvojë pune në profesion, për vendin e punës Këshilltar për planifikim dhe bashkëpunim ndërkombëtar dhe pagesa themelore 36.956,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Shkencat Juridike, Ekonomike apo Shkenca për letërsi më së paku 180 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku një vit për vendin e punës Këshilltar profesional për planifikim dhe bashkëpunim ndërkombëtar dhe pagesa themelore 36.956,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Gjeografin apo Arsim më së paku 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku tre vite përvojë pune në profesion, për vendin e punës Këshilltar për distribuim të të dhënave dhe pagesa themelore 36.956,00 denarë;
- 1 (një) realizues të mbaruar arsim Gjinnazor apo të Mesëm profesional dhe më së paku dy vite përvojë pune në profesion, për vendin e punës Referent i pavarur për ndihmë teknike dhe pagesa themelore 28.395,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Juridik, Ekonomik apo Ndërtimtari dhe ujësjellës më së paku 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku katër vite përvojë pune në profesion nga të cilat më së paku një vit për vendin e punës në sektor publik, gjegjësisht më së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion nga të cilat më së paku dy vite në vend pune udhëheqës në sektor privat dhe provim të dhënë për udhëheqje administruese, për vendin e punës **Udhëheqës të Departamentit për udhëheqje të regjistrat për të drejta mbi patentshmëritë dhe regjistër për deponim të mjeteve në patundshmëri të rezidentëve jashtë vendit dhe jo rezidentëve në RM dhe regjistër të investimeve direkt** dhe pagesa themelore 46.251,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Shkencat Juridike, Ekonomike apo Shkencat Organizative dhe menaxhment, më së paku 180 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku një vit përvojë pune në profesion për vendin e punës Bashkëpunëtorë profesional për furnizime publike dhe pagesa themelore 36.956,00 denarë;
- 2 (dy) realizues me arsim të mbaruar Shkencat Juridike, më së paku 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku tre vite përvojë pune në profesion, për vendin e punës Këshilltar për punë juridike dhe pagesa themelore 36.956,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Shkencat Juridike, më së paku 180 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku një vit përvojë pune në profesion, për vendin e punës Këshilltar profesional për punë juridike dhe pagesa themelore 33.042,00 denarë;
- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Shkencat Juridike, ekonomike apo Politike më së paku 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku katër vite përvojë pune në profesion nga të cilat më së paku një vit për vendin e punës në sektor publik, gjegjësisht më së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion nga të cilat më së paku dy vite në vend pune udhëheqës në sektor privat dhe provim të dhënë për udhëheqje administruese, për vendin e punës **Udhëheqës të Departamentit përkrahje administrative-teknike** të drejtorit - Kabineti i drejtorit - Shef kabineti dhe pagesa themelore 53.101,00 denarë;
- 1 (një) realizues të mbaruar arsim Gjinnazor apo të Mesëm profesional dhe më së paku një vit përvojë pune në profesion, për vendin e punës Arkivues III në Departamentin për punë të përgjithshme dhe komunikim në RRK/RK dhe pagesa themelore 28.395,00 denarë;
- 1 (një) realizues të mbaruar arsim Gjinnazor apo të Mesëm profesional, me ose pa përvojë pune në profesion, për vendin e punës Referent për furnizime në Departamentin për punë të përgjithshme dhe komunikim me RRK/RK dhe pagesa themelore 25.215,00 denarë;
- 1 (një) realizues të mbaruar Informatikën dhe Teknika kompjuterike dhe informatika, më së paku 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku tre vite përvojë pune në profesion dhe të mbaruara kurse specializuese për zhvillim të sistemeve informatike (sisteme operative - windows 2008/2012, baza e të dhënave – MSSQL 2005/2008/2012, për hostim të softuerit aplikativ -IIS, SharePoint 2010, Visual Studio 6.0/2005/2008/2010, C++/C#, .NET, WCF dhe Java, virtualizim – HyperV, Private Cloud). Përparësi por jo dhe e detyrueshme për MSSQL 2005/2008/2012, për vendin e punës Programues të bazave për të dhëna, në Departamentin për zhvillim të sistemeve informatike dhe pagesa themelore 40.625,00 denarë;
- 1 (një) realizues të mbaruar Informatikën dhe Teknika kompjuterike dhe informatika, më së paku 180 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku dy vite përvojë pune në profesion dhe të mbaruara kurse specializuese për administrim të sistemeve informatike (sisteme operative - windows 2008/2012, baza e të dhënave – MSSQL 2005/2008/2012, për hostim të softuerit aplikativ -IIS, SharePoint 2010, virtualizim – HyperV, Private Cloud). E detyrueshme për MSSQL 2005/2008/2012, për vendin e punës Administrues për përkrahje të e-shërbimeve dhe shfrytëzuesve, në Departamentin për përkrahje të sistemeve regjistruese dhe afariste, e-shërbime dhe shfrytëzues dhe pagesa themelore 39.402,00 denarë;
- 1 (një) realizues të mbaruar arsim të Mesëm - arsim Elektroteknik dhe më së paku tre vite përvojë pune në profesion, për vendin e punës Bashkëpunëtorë teknik për infrastrukturë informatike, në departamentin për infrastrukturë informatike dhe pagesa themelore 32.798,00 denarë;
- 1 (një) realizues të mbaruar shkencat Juridike, Ekonomike, më së paku 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku tre vite përvojë pune në profesion, për vendin e punës Ndihmës i personit përgjegjës për punë në RRK Shkup dhe pagesa themelore 47.230,00 denarë;
- 2 (dy) realizues të mbaruar shkencat Juridike, Ekonomike, më së paku 180 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale me ose pa përvojë pune në profesion, për vendin e punës Punëtorë profesional i në RRK Shkup dhe pagesa themelore 32.064,00 denarë;
- 1 (një) realizues të mbaruar arsim Gjinnazor apo të mesëm profesional dhe më së paku dy vite përvojë pune në profesion, për vendin e punës Referent i pavarur për regjistrim, në RRK Shkup dhe pagesa themelore 28.395,00 denarë;
- 1 (një) realizues të mbaruar arsim Gjinnazor apo të mesëm profesional dhe me ose pa përvojë pune në profesion për vendin e punës Referent për regjistrim, në RRK Shkup dhe pagesa themelore 25.948,00 denarë;
- 1 (një) realizues të mbaruar Shkencat Juridike, Ekonomike, më së paku 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku katër vite përvojë pune në profesion nga të cilat më së paku një vit për vendin e punës në sektor publik, gjegjësisht më së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion nga të cilat më së paku dy vite në vend pune udhëheqës në sektor privat dhe vërtetim për provim të dhënë për udhëheqje

administruese, për vendin e punës Person përgjegjës për punë në RRK Tetovë dhe pagesa themelore 40.870,00 denarë;

- 1 (një) realizues të mbaruar shkencat Juridike, Ekonomike dhe Politike, më së paku 180 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku një vit përvojë pune në profesion, për vendin e punës Punëtorë profesional në RK, në RK Gostivar dhe pagesa themelore 31.574,00 denarë;

- 1 (një) realizues të mbaruar shkencat Juridike, shkencat Ekonomike apo Mbrojtje, më së paku 180 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale me ose pa përvojë pune në profesion, për vendin e punës Punëtorë profesional në RK, në RK Gostivar dhe pagesa themelore 30.596,00 denarë;

- 1 (një) realizues të mbaruar Shkencat Juridike apo Ekonomike, më së paku 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku katër vite përvojë pune në profesion nga të cilat më së paku dy vite në vend pune udhëheqës në sektor privat dhe vërtetim për provim të dhënë për udhëheqje administruese, për vendin e punës Person përgjegjës për punë në RRK Manastir dhe pagesa themelore 40.870,00 denarë;

- 1 (një) realizues të mbaruar Shkencat Juridike apo Ekonomike, më së paku 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku tre vite përvojë pune në profesion, për vendin e punës Këshilltar në RRK Prilep dhe pagesa themelore 35.978,00 denarë;

- 1 (një) realizues të mbaruar arsim Gjinnazor apo të mesëm profesional dhe me ose pa përvojë pune në profesion për vendin e punës Referent për regjistrim, në RRK Prilep dhe pagesa themelore 23.991,00 denarë;

- 1 (një) realizues të mbaruar shkencat Juridike, shkencat Ekonomike apo Mbrojtje, më së paku 180 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale me ose pa përvojë pune në profesion, për vendin e punës Punëtorë profesional në RK, në RK Makedonski brod dhe pagesa themelore 30.596,00 denarë;

- 1 (një) realizues të mbaruar arsim Gjinnazor apo të mesëm profesional dhe me ose pa përvojë pune në profesion për vendin e punës Arkivues IV në RRK Veles dhe pagesa themelore 23.991,00 denarë;

- 1 (një) realizues të mbaruar Shkencat Juridike apo Ekonomike, më së paku 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku katër vite përvojë pune në profesion nga të cilat më së paku një vit për vendin e punës në sektor publik, gjegjësisht më së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion nga të cilat më së paku dy vite në vend pune udhëheqës në sektor privat dhe vërtetim për provim të dhënë për udhëheqje administruese, për vendin e punës Person përgjegjës për punë në RRK Strumicë dhe pagesa themelore 40.870,00 denarë;

- 1 (një) realizues të mbaruar arsim Gjinnazor apo të mesëm profesional dhe me ose pa përvojë pune në profesion për vendin e punës Referent për regjistrim, në RRK Strumicë dhe pagesa themelore 23.991,00 denarë;

- 1 (një) realizues të mbaruar Shkencat Juridike apo Ekonomike, më së paku 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku katër vite përvojë pune në profesion nga të cilat më së paku një vit për vendin e punës në sektor publik, gjegjësisht më së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion nga të cilat më së paku dy vite në vend pune udhëheqës në sektor privat dhe vërtetim për provim të dhënë për udhëheqje administruese, për vendin e punës Person përgjegjës për punë në RRK Koçan dhe pagesa themelore 40.870,00 denarë;

- 1 (një) realizues të mbaruar shkencat Juridike, shkencat Ekonomike apo Mbrojtje, më së paku 180 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale me ose pa përvojë pune në profesion, për vendin e punës Punëtorë profesional në RK, në RK Vinicë dhe pagesa themelore 30.596,00 denarë;

- 1 (një) realizues të mbaruar Shkencat Juridike apo Ekonomike, më së paku 240 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale dhe më së paku katër vite përvojë pune në profesion nga të cilat më së paku një vit për vendin e punës në sektor publik, gjegjësisht më së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion nga të cilat më së paku dy vite në vend pune udhëheqës në sektor privat dhe vërtetim për provim të dhënë për udhëheqje administruese, për vendin e punës Person përgjegjës për punë në RRK Kumanovë dhe pagesa themelore 40.870,00 denarë.

Kandidati i cili do të paraqitet në Shpalljen publike, duhet ti plotësojë kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- në mënyrë aktive të njohë gjuhën maqedonase;
- të jetë i moshës së rritur;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesa për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

- Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë të punës, me orar javor të rregullt të punës prej 40 orëve (5 pesë ditë pune në javë)

- Orari ditor i punës zgjatë 8 orë dhe fillon prej orës 8,00 dhe përfundon në ora 16,00.

Bashkë me fletëparaqitjen kandidatët duhet ti dorëzojnë edhe dokumentet në vijim:

- Lutje me biografi të shkurtër (CV);
- Certifikatë shtetësie (kopje);
- Kopje të letërnjoftimit;
- Dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës (Certifikatë mjekësore);
- Dëshmi që me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesa për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë (Diplomë) për arsimin e mbaruar (Kopje);
- Vërtetim për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre (kopje);
- Vërtetim për njohje aktive të një prej tre gjuhëve botërore që përdoren më së shpeshti të Unionit evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)-(kopje);
- Dëshmi për përvojën e punës së nevojshme (dëshmohej me Vërtetim nga APRM apo Fond për SPIM) dhe institucionit në të cilën ka punuar kandidati.

Kandidatët e interesuar, lutjen së bashku me dëshmitë për plotësim të kushteve sipas kësaj shpallje mund ti dorëzojnë në afat prej 5 (pesë) ditëve të punës nga dita e publikimit të shpalljes, drejtpërdrejt në arkivin e Regjistrat qendror të Republikës së Maqedonisë, bul. Kuzman Josifovski Pitu nr. 1 ose përmes postës. Telefoni për kontakt 3 288 100, personi për kontakt Andrijana Anastasovska Kitanova.

Regjistrit qendror të Republikës së Maqedonisë zgjedhjen do ta kryen në afat prej 45 (dyzetepesë) ditë pune pas kalimit të afatit për paraqitje, ndërsa nëse ka më shumë se 200 të paraqitur zgjedhja do të bëhet në pajtim me afatet e caktuara ligjore.

Lutjet e dorëzuara të pakompletuara dhe pas afatit nuk do të merren parasysh.

REAGON EDHE FEDERATA E ZVICRËS

BEHRAMI NUK E KA KUPTUAR PETKOVIÇIN, MBËSHTESIM VENDIMIN E TRAJNERIT

“Nuk mund ta konfirmoj se Valoni është përjashtuar. Trajneri i ekipit i ka kontaktuar disa lojtarë të hënën, më tepër lojtarët me përvojë dhe më të vjetër dhe u ka thënë atyre se ai nuk do të planifikonte të luaj me ta në kualifikimet për 'Uefa Nations League', për tu dhënë mundësi lojtarëve më të rinj. Përpos kësaj, ai u ka thënë atyre se ata edhe më tej mund të bashkohen me ekipin kombëtar, duke vlerësuar nëse ata ende mund të stërviten”, thonë nga Federata Zvicerane e Futbollit

Reagimet ishin të ashpra kur Valon Behrami, të hënën njoftoi se ai ishte përjashtuar nga Përfaqësuesja zvicerane. Trajneri i saj, një gjë të tillë ia kishte thënë atij në një telefonatë të shkurtër. Nuk është aspak e vërtetë, ka thënë të hënën Federata Futbollistike Zvicerane në programin televiziv të SRF 1 “Rendez-vous am Mitag” duke ia hedh fajin Valon Behramit. “Nuk mund ta konfirmoj se Valoni është përjashtuar. Trajneri i ekipit i ka kontaktuar disa lojtarë të hënën, më tepër lojtarët me përvojë dhe më të vjetër dhe u ka thënë atyre se ai nuk do të planifikonte të luaj me ta në kualifikimet për 'Uefa Nations League', për tu dhënë mundësi lojtarëve më të rinj. Përpos kësaj, ai u ka thënë atyre se ata edhe më tej mund të bashkohen me ekipin kombëtar, duke vlerësuar nëse ata ende mund të stërviten. Dhe më pas ai u ka thënë, mendoni për të ardhmen tuaj në ekipin kombëtar dhe lajmërohuni sërish gjatë javës”, pohojnë nga Federata zvicerane e futbollit. “Sigurisht që dyshimi është i justifikuar.



MEDIAT DHE TIFOZËT NË MBËSHTETJE TË BEHRAMIT

Përjashtimi i Valon Behramit është lajmi i ditës në median zvicerane, e cila në përgjithësi ka rezultuar kritike në drejtim të Federatës Zvicerane dhe trajnerit Petkoviç, për mënyrën sesi administruan situatën me mesfushorin. “Federata Zvicerane e humbi kontrollin”, thekson “Noje Zyrher Xaitung”. “Ajo dhe trajneri treguan mungesë respekti ndaj një futbollisti që ka dhënë shumë për skuadrën”. “Re të zeza kanë rënë mbi kombëtaren”, shkruante “Argauer Xaitung”. Ndërsa “Tages Anxaiger” shkruan se largimi i Behramit nga kombëtarja është vetëm zhurma e fundit e ngritur rreth

skuadrës. Situata do të mbetet e nderë pasi çështja e lojtarëve me dy pasaporta është ende shumë e hapur. Një tjetër media, “Tagblat” publikoi një letër të hapur drejtuar Valon Behramit, ku e falënderon për kontributin e madh që ai ka dhënë, ndërkohë që shfaq edhe befasinë për mënyrën sesi e menaxhoi këtë situatë Federata Zvicerane e Futbollit për ta mbyllur letrën me frazën. Derisa, Mesazhe të shumta Valon Behrami ka marrë edhe nga tifozë të shumta zviceranë, një pjesë e mirë e të cilëve nuk i kursyen kritikën ndaj Petkoviç, në rrjetet sociale.

fikuar. Mendoj se ka pasur shumë emocione. Valon Behrami është një person emocional, për këtë edhe është shndërruar në një futbollist të shquar. Gjithashtu për ekipin kombëtar zviceran. Muapër atë se sjell shumë emocione në lojë. Por unë mendoj se në këtë rast, ai nuk e ka kuptuar atë që ka menduar trajneri kombëtar. Ai nuk ka marrë një vendim të caktuar, nuk është marrë asnjë vendim zyrtar, asnjë lojtar nuk është përjashtuar nga skuadra kombëtare”, vazhdojnë më tej nga FFZ.

Për komunikimin e keq të Petkoviçit, Marko von Ah, shefi i komunikimeve me mediat ka pohuar ka thënë: “Kjo po më habitë. Katër nga pesë lojtarë e kanë kuptuar mesazhin shumë mirë. Unë u habita që u bë një problem aq i madh kur dihet se që të dy personazhet në mes vete komunikojnë në gjuhën

italiane të cilën e njohin shumë mirë dhe gjithmonë kishte një marrëdhënie të mirë. Po që se trajneri do të kishte vendosur ta largojë Behramin, ai këtë gjë nuk do ta kishte bërë përmes telefonit. Kontakti ishte menduar si një lloj sondizimi. Mendoj se është e arsyeshme që ai ta bëjë këtë në telefon, edhe në kuptimin e efikasitetit, pasi ka pasur disa telefonata që nuk morën kohë as edhe vetëm 2 minuta. Kjo ishte arsyeja pse ky rast është i justifikueshëm. Kur është fjala për marrjen e një vendimi të detyrueshëm, gjërat janë më ndryshe. Po që se trajneri thotë ‘jo’, ky do të ishte një vendim i pastër sportiv, i cili u bë vetëm nga ai vetë, pa asnjë prapavijë sportive-politike. Paraprakisht, ai nuk e diskutoi vendimin me kryetarin (Peter Gillieron) ose me sekretarin e përgjithshëm (Aleks Miesher). Trajneri ka autonominë

dhe mbështetjen e federatës. Ai duhet të kujdeset për përbërjen e ekipit dhe të ardhmen e tij pas pjesëmarrjes në Kupën së Botës. Këto janë procese normale”, thotë Marko von Ah.

Lidhur me shqiponjën, Ah ka deklaruar: “Ne kemi punuar në këtë çështje, në të cilën kemi pranuar publikisht se kemi bërë gabime. Nuk e filluam keq, në aferën me shqiponjën dykrenare, menaxhmenti i federatës menjëherë u vendos në mes të lojtarëve dhe pastaj arriti të qetësojë gjërat. Më pas, ne personalisht e aktualizuam temën e që gjërat nuk shkuan shumë mirë. Kërkuam ndjesë për këtë dhe e bëmë të qartë se nuk duam të diskriminojmë, diskreditojmë apo pengojmë askënd. Nuk mendojmë se gjithçka ka përfunduar. Mbeten ende detyra për tu bërë”, përfundoi Marco von Ah.



Sadiku nis rikuperimin me një premtim për tifozët!

Pas operacionit që kreu Armando Sadiku ka nisur fazën e rehabilitimit për t'u rikuperuar nga dëmtimi që do ta mbajë rreth 6 muaj jashtë fushave të futbollit, me sulmuesin kuqezi që do të humbasë jo vetëm fazën e parë të La Ligas por edhe ndeshjet me Shqipërinë në Ligën e Kombeve turneun më të ri që do të startojë në shtator në nivel përfaqësuesesh. Me dëmtimin që pësoi në gju në miqësoren mes Levantes dhe holandezëve të Herenveen, Sadiku humbi edhe mundësinë për t'u transferuar në një tjetër kampionat gjatë kësaj vere. Megjithatë sulmuesi i kombëtares shqiptare nuk dorëzohet dhe me një postim në rrjetin e tij social “Facebook”, ka premtuar të gjithë fansat e tij se do të rikthehet në fushë më i fortë se kurrë. “Diçka e papritur më ndodhi! Por, falë ndihmës së Zotit çdo gjë shkoi mirë dhe sot u ktheva në shtëpi pas operacionit! E di që nuk do të jetë e lehtë të qëndroj për një kohë të gjatë jashtë fushës. Por kush më njeh e di mirë që nuk është hera e parë për mua një dëmtim i tillë. Fjalët nuk më pëlqejnë shumë, por do të punoj fort të kthehem përsëri në fushën e gjelbër! Faleminderit te gjithëve për mesazhet inkurajuese që më keni dërguar. Ju përshëndes Armando”, shkroi në “Facebook”, Sadiku.

KUPA E MAQEDONISË, XHIROJA E PARË

Shkëndija e nis kundër Kozhuvit

Shkup, 8 gusht - Fituesi aktual i Kupës së Maqedonisë KF Shkëndija, mbrojtjen e trofeut do ta nis me ndeshjen si mysafir në Cjvegje- li ndaj Kozhuvit. Kështu vendosi shorti, i cili u hedh të mërkurën në ambientet e Federatës Futbollistike të Maqedonisë. FC Shkupi do të jetë mysafir i anëtarit të ri të Ligës së dytë, Kit Go nga Pehçeva, Renova gjithashtu si mysafir do të përballlet me Tikveshit në Kavadar, ndërsa

Struga Trim Lum si nikoqir do të përballlet me Pobodën. Edhe skuadra tjetër shqiptare, KF Korabi që luan në Ligën e dytë - Perëndim, do të luan si vendas përballë Borec-it, kurse Vëllazërimi nga Kërçova do të jetë nikoqir i Bellasicës. Skuadra nga lagja Hasanbeg e Shkupit, Fortuna do të sfidojë anëtarin e Ligës së parë, Rabotniçkin. Ndërkohë, Vardari do të përballlet me Vardarin nga Fortuna, kurse veçohet përbal-

lja mes Teteksit dhe Gostivarit, e cila do të luhet në Tetovë. Të gjitha ndeshjet e raundit të parë të Kupës së Maqedonisë në program janë me datë 22 gusht.

DYSHET:
Kozhuvit – Shkëndija
Kit Go – FC Shkupi
Tikveshi – Renova
Struga TL. – Pobeda
Korabi – Boreci



Vëllazërimi – Bellasica
Fortuna – Rabotniçki
Teteksi – Gostivari
Vardari Forino – Vardari
Vardar Negotino – Skopje

Labunishta – Akademia P.
Peshevo – Bregalnica
Osogovo – Pelisteri
Bratsvo - Vllaznimi – Sileksi
Prevalleci – Mkd.Gj.P.

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit të të punësuarve në sektorin publik dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit të marrëdhënieve të punës, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, bën

SH PALLJE

për

punësim me kohë të caktuar deri më 31.12.2018

1. Për nevojat e themelimit të marrëdhënieve të punës për kohë të caktuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë për vendin e punës siç vijon:

1. Bashkëpunëtor shërbimeve për mbështetjen e punësimit në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë – Qendra e punësimit në qytetin e Shkupit – (1) një realizues

Kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta siç vijojnë:

- Arsimin e lartë, përkatësisht të ketë së paku 180 kredi të arritura sipas EKTS-së ose të ketë mbaruar shkollën VIII/1;
- Të ketë së paku dy vjet përvojë pune në profesion;
- Të ketë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Të ketë njohje aktive të njërës prej tri gjuhëve që më së shpeshti përdoren në Unionin Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Rroga themelore neto për vendin e punës do të jetë 23.230,00 denarë.

Bashkë me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe:

- Dëftesën/ diplomën për mbarimin e nivelit arsimor;
- Vërtetimin/ dëshminë për përvojën e punës;
- Vërtetimin/ dëshminë për njohjen e programeve kompjuterike për punë zyre;
- Vërtetimin/ dëshminë për njohje aktive të gjuhëve
- Dëshminë se nuk është shqiptuar ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Vërtetimin e shtetësisë;

II. Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë pune – 40 orë në javë, nga e hëna deri të premten; ndërsa orari i punës ditore është prej 07:30 deri 15:30.

III. Bashkë me fletëparaqitjen, kandidatët duhet të dorëzojnë dëshmi me të cilat vërtetohet plotësimi i kushteve të parapara.

IV. Shpallja do të jetë e hapur tri (3) ditë pune, duke filluar nga data e botimit në shtypin ditor.

V. Fletëparaqitjet me dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzohen në arkiv nëpërmjet postës në adresën siç vijon: Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë – shërbimi qendror, rruga "Vasil Gjorgov" nr. 43, Shkup.



FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

SH PALLJE

**PASQYRË E AKSIONEVE NË PRONË TË FONDIS
QË DO TË OPROHEN PËR SHITJE NË BURSËN
E MAQEDONISË PËRMES ANKANDIT PUBLIK BURSAR
NË TRE DITË RRESHT TË TREGËTIMIT, DUKE FILLUAR NGA 24.08.2018**

SHITJA E AKSIONEVE PRIORITARE

Numër rend.	Shoqëria aksionare	Vendi	Numri i aksioneve për shitje	Vlera nominale e shoqërisë në EURO	Vlera nominale e kapitalit për shitje (EURO)	Pjesëmarrja e kapitalit për shitje në vlerën e shoqërisë në %	Çmimi fillestar shitës i një aksioni në EURO
1	STELL-ER SHA Shtip	Shtip	12,892	534,348	65,878	12.33%	9.20

Aksionet do të ofrohen për shitje përmes bursës së Maqedonisë në tre ditë rresht të tregëtimit duke filluar nga 24.08.2018. Shitja e aksioneve do të bëhet sipas modelit "të gjitha ose asgjë" me çka aksionet do të shiten në pako përmes një transakcioni. Paguesa do të bëhet në para të gatshme dhe në denarë sipas kursit të këmbimit të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e shitjes.

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

www.piom.com.mk



**REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS**

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SH PALLJE PUBLIKE NUMËR – 138/2018

për punësimin e 1 nëpunës publik nga grupi I, nëngrupi II në „Institucion publik komunal për fëmijë Çerdhen e fëmijëve , Detelinka”- Kriva Pallankë “për vendet e punës në vijim:

1. DEZ0102B01002 Këshilltar - Kontabilist, Shërbimi për punë administrative dhe menaxhim me resurset njerëzore 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveu i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca ekonomike ose shkenca organizuese dhe menaxhim (menaxhment)
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërjegjegjim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Rroga neto: 25.023,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1. Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës. Afati i aplikimit zgjatet 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë. Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë. Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ. Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar. Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inçizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës. Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

I nr. 713/2018

SH PALLJE PUBLIKE

(Në bazë të nenit 46-b, të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përparim, Gazeta zyrtare nr. 8 të datës 17.01.2008)

Përmbaresi Vanço Markovski duke vepruar sipas propozimit të kreditorit UNI BANKA SHA SHKUP nga Shkupi dhe me seli në rr. Maksim Gorki nr. 6, kundër borxhliut Nazif Iljazi nga Tetova me banim në rr. Jordan Zllatanoski nr. 50, për shkak të realizimit në të holla, më datë 31.07.2018,

FTON

Borxhliun Nazif Iljazi i lindur më datë 17.10.1993 të paraqitet në zyrën e përmbaresit në rr. Ilindenska nr. 64 Tetovë, për shkak të dorëzimit të akteve në vijim:

- Urdhëresës për përparim I nr. 713/2018 të datës 18.06.2018, të përpiluar në bazë të nenit 226 paragrafi 2 të LP;
- Urdhëresës për përparim I nr. 713/2018 të datës 18.06.2018 të përpiluar në bazë të nenit 166 të LP;
- Konkluzionit për mënyrën e dorëzimit nga data 31.07.2018.

NË AFAT PREJ 1 (NJË) DITË, duke konsideruar nga dita e publikimit të fundit të kësaj fese publike në shtypin ditor. **PARALAJMËROHET** borxhliu Nazif Iljazi se mënyra e këtillë e dorëzimit konsiderohet si dorëzim në rregull dhe se për pasojat negative që mund të dalin do t'i bartë vet pala.

Kjo shpallje paraqet **SH PALLJEN E DYTË** të thirrjes publike.

PËRMBARESI

Vanço Markovski



Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Ministria e bujqësisë pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave

Bëhet korigjimi i Shpalljes publike nr.08/18 për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe mbi 3 hektarë përmes ankandit publik elektronik e botuar në ("Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr.144/18) nga 3 gusht 2018 dhe në gazetën ditore Sloboden Peçat, Nova Makedonija dhe Koha me datë 06 gusht 2018.

Në preambulën e shpalljes publike fjalët "neni 21 paragrafi 1" zëvendësohen me fjalët "neni 21-a paragrafi 1" dhe fjalët "deri 3 hektarë" zëvendësohen me fjalët "mbi 3 hektarë".

Dispozitat tjera në Shpalljen publike mbeten të njëjta.

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo + Pr + 1 + Nën, trualli i parë në "Momin Potok" – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithejsh 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

Klubi nuk ka nevojë për financa sikurse klubet tjera, por shitja e lojtarëve është e domosdoshme shkaku i numrit. Afati kalimtar në Spanjës zgjat deri në fund të muajit, por ai i Ligës Premier mbyllet të enjten në mbrëmje

Një skuadër prej 27 lojtarësh, por Barcelona është larg limitit të regjistrimit në La Liga, ku Ernesto Valverde kërkon të zvogëlohet numri i madh i lojtarëve pasi dëshiron të punojë me një numër të caktuar në sezonin 2018/19. Klubi nuk ka nevojë për financa sikurse klubet tjera, por shitja e lojtarëve është e domosdoshme shkaku i numrit. Afati kalimtar në Spanjës zgjat deri në fund të muajit, por ai i Ligës Premier mbyllet të enjten në mbrëmje. Barcelona ka oferta për disa lojtarë të saj pikërisht nga klubet e Ligës Premier.

JERRY MINA

Evertoni dhe Manchester Junajtedi janë ndër ato klube që janë të interesuar për kolumbianin dhe Barcelona nuk ulet nën çmimin e 40 milionë eurove.

ANDRE GOMES

Portugezi ka dal një dështim i madh, por Uest Hemi ka shfaqur interesim për të. Me kaq shumë mesfushorë qendrorë në klub, Blaugra-

BARCELONA BËN GATI TI SHESË LOJTARËT E PADËSHIRUAR



na duhet t'i gjejnë zgjidhje lojtarit.

PAKO ALKASER

Ernesto Valverde ka vendosur që ta ndal Munir El Haddadi si sulmues zëvendësues duke i hapur derën Alkaserit. Sautemptoni ka qenë i lidhur me të.

MARLON SANTOS

Shumë klube të Ligës Premier e duan mbrojtësin me Sautemptoni,

Leicesterin dhe Uest Hemi që janë në garë.

SERGI SAMPER

Është e vështirë të dish se ku do të kalojë mesfushori. Pas një numri të lëndimeve dhe huazimeve, asnjë klub anglez nuk po e ndjek seriozisht.

RAFINJA

Valverde ka marr vendim për

të, pasi luajti mirë në ndeshjet e para sezonit. Arsenali ishte skuadra më e interesuar, por spanjollët nuk e ulin çmimin.

JASPER CILLESSEN

Holandezi dëshiron të largohet dhe ka oferta, por asnjëra nuk përputhet me kërkesat e Barcelonës. Klubi nuk dëshiron ta humbasë portierin për një shumë të vogël.

PAGAT NË SERIE A



Ronaldo fiton tri herë më shumë se sa Higuain

Këtë verë ndodhi një nga transferimet më të mëdha në histori të futbollit, ku Cristiano Ronaldo kaloi nga Real Madridi te Juventus. Cristiano Ronaldo u bashkua me Bianconerët për një marrëveshje në vlerë 100 milionë euro. Fituesi i pesë 'Topave të Artë' ka nënshkruar kontratë katërvjeçare me Juventusin deri më 30 qershor 2022. Ardhja e Ronaldos në Torino ka bërë që Gonzalo Higuain të largohet drejt Milanit. Cristiano Ronaldo është larg lojtari më i paguar në Serie A pasi fiton 31 milionë euro në sezon.

Higuain i Milanit është i dyti, me tri herë më pak pasi fiton 9 milionë euro në sezon, që është 22 milionë më pak se KR7. Paulo Dybala fiton 7 milionë euro, ndërsa Daglas Kosta është me gjashtë milionë. Edhe Donnarumma fiton sa braziliani i Juventusit. Leonardo Bonuçi ka qenë më i paguari në Serie A por kalimi te Juventus, ka bërë ë paga e tij të bie në 5.5 milionë euro.

Top10

1. Cristiano Ronaldo 30 mln euro
2. Higuain 8.5
3. Dybala 7
4. Donnarumma 6
5. Daglas Kosta 6
6. Bonuçi 5.5
7. Ikardi 5
8. Pjaniç 4.5
9. Xheko 4.5
10. Insigne 4.5
11. Mertens 4.5

Bolt nis stërvitjen me skuadrën australiane

Ish-atleti Usain Bolt ka nisur zyrtarisht fazën përgatitore me skuadrën australiane të Central Coast Mariners, me shpresën që sa më shpejt të debutojë me një ekip profesionist. Rekordmeni i botës në 100 dhe 200 metra, i tërhequr nga atletika një vit më parë, nuk e ka fshehur asnjëherë ëndrrën e tij për të luajtur si futbollist profesionist. Ndaj, ai ka nënshkruar një kontratë me ekipin e Australian A-League një muaj më parë dhe tani ka nisur përgatitjen. Trajneri i skuadrës,



Mik Mulvej u shpreh se pavarësisht famës, Bolt do të trajtohet njësoj si të gjithë futbollistët e tjerë. Kjo periudhë do të jetë një fazë

përgatitore, një test për sprinterin xhamajkan dhe pas disa ditësh do të merret vendimi përfundimtar nëse Bolt do të nënshkruajë një kontratë apo jo. "Unë jam i kënaqur që kam një personazh të tillë në ekip, që do ta stërvis këto ditë. Jam i bindur se Bolt do të tregojë më të mirën e tij për të siguruar kontratën. Nëse gjërat do të funksionojnë, atëherë ai do të sigurojë një kontratë. Nuk do të ketë trajtim special, pasi do të punojë bashkë me pjesën tjetër të skuadrës", deklaroi Mulvej.

MARADONA "I VË FLAKËN" ARGJENTINËS



Kur ankohen dhe zemërohen legjendat, gabimi është i atyre që janë burim i kësaj gjendjeje. Diego Armando Maradona ka shprehur zemërimin, pasi askush nuk e ka propozuar për të qenë pjesë e garës për trajnerin e ri të Argjentinës. Kombëtarja ka nevojë urgjente për një trajner të ri, ku Sampaoli u shkarkua pas dështimit në Kupën e Botës, një aventurë e cila u mbyll pa asgjë në Rusi. Maradona ka vetë-ofruar veten si kandidat të mundshëm për stolin e Kombëtares, por duket se askush nuk e ka më në listë. Për këtë, ai ka shprehur irritimin në rrjetet sociale duke akuzuar edhe mediat, të cilat nuk e kanë përmendur em-

rin e tij. "Sa i përket ekipit kombëtar argjentinas, dua të them se më shqetëson fakti, që disa gazetarë nuk më përfshin në mesin e trajnerëve të mundshëm. Dëgjoja Çavo Fucks, për shembull, dhe ai as nuk më emëronte midis kandidatëve të mundshëm. I mbaj mend fillimet e tij, kur isha ende duke luajtur dhe duket se tani ai nuk më njeh më. Unë gjithashtu shpreh keqardhje që nuk jam marrë parasysh nga disa gazeta argjentinase, të cilat flasin për ish-trajnerë të tjerë, por jo për mua. Por, hej, kjo është media sportive që kemi ne argjentinasi"- përfundon reagimi i legjendës në "Instagram"

KINA NDALON FILMIN "CHRISTOPHER ROBIN", SHKAK NGJASHMËRIA E PRESIDENTIT ME ARUSHIN

Filmi "Christopher Robin", bazuar në historinë e Winnie the Pooh, nuk do të jetë në kinematë kineze. Autoritetet nuk kanë dhënë një arsye zyrtare, por mendohet se vendimi për ndalimin e filmit ka të bëjë me ngjashmërinë e presidentit kinez Xi Jinping me arushin e famshëm.

Winnie është shndërruar në simbolin e rebelimit dhe të opozitarizmit në Kinë, shpesh i përdorur për të ironizuar presidentin në media dhe rrjete sociale.

Diçka e ngjashme ndodhi edhe në 2013, kur Xi zhvilloi një vizitë në Shtetet e Bashkuara. Faqet e para të shtypit amerikan u hapën me krahasime të tilla, Jinping me Pooh dhe Obama me tigrin. Një vit më pas, në takimin e liderit të vendit komunist me homologun e tij japonez



Shinzo Abe, krahasimi ishte i pashmangshëm. Fushata kundër Winnie gjithsesi ka



nisur që në verën e kaluar në Kinë me bllokimin e imazhit të tij në rrjete sociale.



Rosat në vend të pesticideve!

Rosat? Po, po, rosat! Kjo mënyrë antike e të bërit bujqësi po bëhet sërish popullore për shkak të dëmtimeve në mjedis të shkaktuara nga kimikatet. Rosat të shumuara specifikuat futen te parcelat me oriz për t'u ushqyer me insekte dhe barishte, duke i lënë plantacionet e orizit të padëmtuara. Ato madje hanë edhe farat e barërave dhe jashtëqitjet e tyre shërbejnë si fertilizues për tokën, duke reduktuar kështu nevojën për fertilizues kimikë, herbizide apo pesticide. Megjithatë fermerët duhet t'i largojnë rosat gjatë kohës së të korrave, në mënyrë që të mos hanë orizin. Ekzistojnë më shumë se 1000 mijë lloje pesticidesh në të gjithë botën. Pesticidet mund të jenë toksike për njerëzit dhe kafshët dhe mund të qëndrojnë në tokë dhe ujë për vite të tëra. Por në zonat ku ka mungesa ushqimore mund të mbrojnë dhe shtojnë prodhimet bujqësore. A duhet që fermerët në vendin tonë të përdorin metoda më natyrale për kultivimin e kulturave?

Kujdesi për shëndetin kur moti ndryshon

Një ditë me diell, kurse shi në ditën tjetër. Vendi ynë po kalon në një mot vështirë të parashikueshëm, andaj edhe është me rëndësi që të dini si të kujdeseni për shëndetin tuaj edhe në këtë kohë.

PUSHONI. Nëse zgjimi në mëngjes ju lodh më shumë se që ju freskon, atëherë ka mundësi që gjumi që bëni nuk është cilësor. Synoni që t'i bëni 7-8 orë gjumë në këto kohë së paku, kështu forconi sistemin imunitar dhe largoni mbetjet e padëshiruara nga organizimi.

KONSUMONI LËNGJE. Lëngjet e freskët dhe vitamina C janë një mënyrë e mirë për të filluar mëngjesin. Ju ndihmojnë për imunitetin dhe shëndet të mirë. Po ashtu, preferohet që të pini shumë ujë, në mënyrë që trupi juaj të mbrohet nga sëmundjet apo infeksionet.

PASTRONI AJRIN. Ndryshimet e stinëve mund të jenë faktorë për alergji, si algjeria nga poleni. Është shumë me rëndësi që ta freskoni ajrin në dhomën tuaj. Ajrosja gjithnjë është e mirëseardhur për largimin e pluhurit.



Të mësuarit gjatë gjumit ka kufizime

Shkencëtarët belg kanë konstatuar se mundësitë e të nxënir përderisa flenë janë të kufizuara. Shkencëtarët e institutit ULB për neuroshkencë, kanë zbuluar se truri mund të përpunojë tinguj edhe gjatë kohës së gjumit, por se atëherë nuk mund t'i grupojë të njëjtit. Ekipi i shkencëtarëve të cilin e kryesoi Philippe

Peigneux, analizoi aktivitetet e trurit të të anketuarve me magnetoencefalografi (MEG). Gjatë studimit janë regjistruar përgjigje në trurin e të anketuarve, por për disa tinguj të veçantë, megjithatë nuk është marrë një e dhënë për grupimin e tyre. Studimi në fjalë është publikuar në magazinën "Scientific Reports".



48 BC - Lufta civile e Cezarit: Beteja e Farsalusit - Jul Cezari në mënyrë mashtruese mund Pompein në Farsalus dhe Pompeji lundron për në Egjipt.

378 - Beteja e Adrianopojës: Kalorësia e Vizigotit mund Ushtrinë Romake.

681 - Themelohet Bullgaria si një pushtet hani në bregun jugor të Lumit Danub, pasi të mund ushtritë bizantine të Perandorit Konstantin IV në Deltën jugore të Lumit Danub.

1173 - Fillon ndërtimi i Kullës në Pisa, dhe zgjatë dy shekuj për t'u kompletuar.

1378 - Kardinalët shpallin Papa Urbanin VI të paligjshëm (anti krishterë/djall).

1483 - Hapet Kisha Sistina.

1803 - Kuajt e parë sillen në Havai.

1810 - Napoleoni përvetëson Vestfalinë si pjesë të Perandorisë së parë franceze.

1848 - Austria dhe Sardenja nënshkruajnë armëpushim.

1849 - Republika hungareze shkatërrohet nga Austria dhe Rusia.


1965 - Singapori fiton pavarësinë nga Malajzia (Dita kombëtare).



Shkencëtarët kinezë kanë arritur me sukses të prodhojnë llojin unik të orizit, i cili rritet në ujë të njelmët, dhe i cili mund të ushqejë rreth 200 milionë njerëz në botë. Studimi është kryer në Qendrën për kërkim dhe hulumtim në Chingdao, ku shkencëtarët merren me rritjen e orizit rezistues ndaj ambientit të njelmët dhe alkal, në krahinën Shandong. Orizi i quajtur "juen mi", është prodhuar me ndihmën e ujit të Detit të Verdhë.

DASHURIA

- Arta, jam çmendur pas teje.
- Mirë, mirë, por rri larg babait tim.
- Pse, është i ashpër me djemtë që të vij në rrotull?
- Jo, por është drejtor i Spitalit Psikiatrik.



Nëse kërkon të jetosh një jetë të lumtur, kushtoja një qëllimi, jo një personi, apo një objekti.

(Albert Einstein)



KALENDARI HISTORIK 9 GUSHT



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS